



Manual për të burgosurit e burgut Sollicciano

Manual i bërë për rregullat e burgut dhe
për shërbimet e të burgosurve

ALBANESE

Manual për të burgosurit e burgut Sollicciano

Manual i bërë për rregullat e burgut dhe
për shërbimet e të burgosurve

ALBANESE
2^o edizione novembre 2007

Publikim i bërë nga Këshilli i Sektorit të Tretë për Pritja dhe Integrimin e Komunës së Firences në bashkëpunim me Drejtorinë e Kompleksit të Ri të Burgut Sollicciano.

Tekstet: Drejtoria *NCP Sollicciano* - Zyra Pedagogjike dhe Drejtoria Sanitare, Shoqata *Altro Diritto* dhe Zyra e Ndërhyrjeve në Burg të Komunës së Firences. Revizionimi është bërë nën kujdesin e Zyrës së Mbikqyrjes të Firences.

Koordinimi është bërë nën kujdesin e zotit Marco Verna - Zyra e Ndërhyrjeve në Burg, Via Verdi, 24 - tel. 055.2769785 - mail: m.verna@comune.fi.it - www.comune.firenze.it/detenuti

Organizimi botues: *Comune Network*.

Përgjegjësi *Comune Network*: Maria Siponta De Salvia

Koordinimi botues *Comune Network*: Marta Cavini

Përkthimi i teksteve: *CAT Cooperativa Sociale Onlus - UCODEP Onlus*
Grafikët dhe faqesjet: Studio Dueeventi Comunicazione

Stampimi: Tipografia Komunale e Firences

Teksti është i gatshëm në gjuhët, që vijojnë: Shqip, Arabisht, Kineze, Frengjisht, Anglisht, Rumanisht, Spanjisht.

Falenderojmë redaksinë “Ristretti”, që na dha tekstin-bazë.

>>> Treguesi <<<

> Paraqitja e Këshilltares për Integrimin e Komunës së Firences Lucia de Siervo	7
> Paraqitja e Drejtorisë NCP Sollicciano	8
> 1. Jeta e Institutit dhe marrëdhënia me operatorët	9
1.1 Orët e para si i burgosur	9
1.2 Rregullat e sjelljes	10
1.3 Personeli i Institutit	13
1.4 Takimet, telefonatat dhe posta	14
1.5 Shpenzimet	16
1.6 “Kërkesa” (<i>La domandina</i>)	16
1.6.1 Trasferimi	18
1.7 Shkollat, formimi profesional, aktivitetet kulturore dhe sportive	19
1.7.1 Komisioni Vitto	19
1.7.2 Komisioni i të burgosurve	20
1.8 “Kodi fiskal” (<i>Il Codice Fiscale</i>)	20
1.9 Mbështetja fetare	20
1.10 Votimet politike dhe referendumi	21
1.11 Garanti për të drejtat e të burgosurve	21
1.12 Seksioni Femëror	22
> 2. Kujdesi i shëndetit në burg	23
2.1 Rregullat e përgjithshme për një jetë sa më të shëndetshme në Burg	23
2.2 Rëndësia e higjienës	24
2.3 Rregullat për pastërtinë	25
2.4 Marrëdhëniet me shërbimin sanitar	25
> 3. Ligjet më me shumë interes të burgut	27
3.1 Mbrojtja në ngarkim të Shtetit (Mbrojtje Falas)	27
3.2 Arsyet për të cilat ndodheni në burg	28
3.3 Gjyqi dhe format e ndryshme të gjykimit:	29

Gjykimi i shkurtuar. <i>Il giudizio abbreviato</i>	
Kompromisi. <i>Il patteggiamento</i>	
Letërthirrja direkte përballë Gjykatësit Monokratik. <i>Citazione diretta davanti al Giudice Monocratico</i>	
Gjykimi i drejtpërdrejtë. <i>Il giudizio direttissimo</i>	
Gjykimi i menjëhershëm. <i>Il giudizio immediato</i>	
Gjykimi i zakonshëm. <i>Il giudizio ordinario</i>	
3.4 Përfitimet e burgut dhe masat alternative për burgosjen:_____	32
Lirimi i parakohshëm. <i>La liberazione anticipata</i>	
Lejet e shpërblimit. <i>I permessi premio</i>	
Puna e jashtme. <i>Il lavoro esterno</i>	
Gjysëm-liria. <i>La semilibertà</i>	
Vënia në provë tek shërbimet sociale. <i>L'affidamento in prova ai servizi sociali</i>	
Vënia në provë në “raste të veçanta”. <i>L'affidamento in prova in "casi particolari"</i>	
Pranimi tek masat e ndryshme për të burgosurit e sëmurë me Sidë të deklaruar ose me një imunificencë të rëndë. <i>L'ammissione alle misure alternative per condannati affetti da A.I.D.S. conclamato o da grave deficienza immunitaria</i>	
Burgimi shtëpiak. <i>La detenzione domiciliare</i>	
3.5 Falja _____	41

➤ 4. Administrimi i raporteve juridike me institucionet _____ 42

4.1 Analiza e rrezikshmërisë sociale dhe anulimi i dëbimit _____	42
4.2 Rinovimi i Lejes së Qëndrimit _____	43
4.3 Rregullat e burgjeve europiane _____	43
4.4 Transferimet jashtë Shtetit të personave të dënuar _____	44
Si të kërkon transferimin?	
Çfarë ndodh pas transferimit?	
4.5 <i>Ekstradimi</i> është dorëzimi i personit nga një Shtet në tjetrin, në të cilin është dënuar për një krim. (<i>Estradizione - consegna di una persona da uno Stato ad un altro, nel quale sia stato condannata per un reato</i>) _____	45

➤ 5. Administrimi i raporteve ekonomike me institucionet _____ 47

5.1 Gjoha dhe riparimi material apo moral i një dëmi. <i>La multa</i>	
---	--

<i>e l'ammenda</i>	47
5.2 Harxhimet gjyqësore dhe të mbajtjes në burg	49
5.3 Dëmshpërblimi	50

➤ 6. Sporteli i dokumentave dhe kujdesi i tyre. *Sportello documenti e tutele*

<i>documenti e tutele</i>	51
6.1 Dobitë për mbështetjen e të ardhurave dhe dokumenta të tjera	51
6.2 Vendbanimi civil	51
6.3 Dokument të identitetit personal dhe të tjera çertifikata të gjendjes civile	52
6.4 Kompensim papunësië me cilësi të reduktuara. <i>Indennità di disoccupazione con requisiti ridotti</i>	52
6.5 Çeqet familjare. <i>Assegni familiari</i>	53
6.6 Regjistrimi në zyrën e punës së zakonshme dhe në atë për invalidët. <i>Iscrizione al collocamento ordinario e per i disabili</i>	55
6.7 Pensionet e pleqërisë, invaliditeti dhe shoqëroret. <i>Pensioni di anzianità, invalidità e sociale</i>	56

➤ 7. Rrjeti qytetar i shërbimeve - Zona e ekzekutimit penal brenda dhe jashtë burgut

7.1 Zyrat Publike	63
-------------------------	----

> Paraqitja e Këshilltares për Pritjen < dhe Integrimin e Komunës së Firences

Qyteti i Firences nuk do, që të harrojë qytetarët e burgosur, që banojnë në territorin e tij. Sistemi i burgut italian ka nevojë për gjëra të reja, duke përfshirë strukturat e pranishme në territorin e Firences.

Administrata Komunale, në rrethin e kompetencave të tij, angazhohet për të përmirësuar jetën e qytetarëve të burgosur duke investuar në aktivitetet trajtuese, në fushën edukative, sportive, kulturore dhe të formimit profesional dhe duke kërkuar të favorizojë mbështetjet e jashtme.

Ky manual është në përputhje me këtë impostim: të bësh sa më të thjeshtë qëndrimin në institutet e burgjeve. Duke patur parasysh, që në qoftë se, nuk dihet që kemi të drejta dhe nuk jemi në pozicionin për tu mbrojtur, atëherë është njësoj sikur nuk kemi të drejta, ky manual pa qenë i tepruar, mund të përfaqësojë një mjet drejtësie dhe garancie. Për këtë u aktivizua, kur na është komunikuar nevoja nga *qytetarët e burgosur* për të patur një informacion të thjeshtë mbi jetën e burgut në të gjitha aspektet e tij dhe mbi rendin gjyqësor italian.

Objektivi është pikërisht paisja e qytetarëve të burgosur me një mjet të dobishëm, që do tu shërbejë për njohjen e të drejtave dhe detyrave të tyre, i cili gjithashtu do të tregojë sjelljet më të përshtatshme në situatat, që mund të verifikohen nga hyrja në burg deri në zh'burgosje: nga hyrja, në mënyrën e lajmërimit të familjarëve dhe në rast se, autoritetet e konsullatave, si mund të keni një avokat dhe si mund të raportoheni me personelin e burgut.

Rëndësi të madhe iu kushtua temës mbi shëndetin dhe sistemit gjyqësor, e në veçanti sistemit të dobive të parashikuara nga rendi gjyqësor.

Në fund, manuali mbyllet me listën e shoqatave, që merren me burgun, një listë me të dhënat për t'i kontaktuar dhe fushën e ndërhyrjeve.

Objektivi ynë themelues është, që ta bëjmë Sollicciano një burg për mos ta patur turp.

Lucia De Siervo
Këshilltare për Pritjen dhe Integrimin e Komunës së Firences
(Assessore all'Accoglienza e Integrazione del Comune di Firenze)

> Paraqitja e Drejtorisë < NCP Sollicciano

Përshtëndes me kënaqësi nxjerrjen në shtyp të këtij Manuali për të Burgosurit, të përkthyer në shumë gjuhë, për t'ia shpërndarë popullit në institutin fiorentin Sollicciano.

Ndihet me të vërtet nga Administrata e Burgut nevoja për të përmirësuar kuptimin e rregullave organizative të burgut, të figurave institucionale të referimit, të rregullave bazë, formale dhe informale, që bëjnë të mundur jetesën në Institut, për të përmirësuar kuptimin reciprok midis të burgosurve dhe personelit, dhe si analizë e fundit, për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave, që i përkasin të burgosurve.

Është e njohur në institutet fiorentine të dënimit dhe në ata të të gjithë Italisë, prania e të burgosurve të huaj (rreth 60%), që nuk flasin dhe nuk kuptojnë mirë italisht dhe të burgosurve italian, të cilët janë me nivel të ulët shkollor dhe me vështirësi integrimi personal dhe shoqëror.

Të dyja kategoritë kanë probleme të mëdha për të kuptuar normativat e burgut në profilin e detyrave, të rregullave, të kufijve të jetës së burgut, por edhe të të drejtave, si ajo e shëndetit, e punës, e takimeve, e mundësisë për të hyrë në masat alternative, gjithashtu, është themelore dhe për vetë të drejtën të kuptojë normat.

Një nga mundësitë për të përballuar këtë situatë, e përdorur dhe në burgjet e tjera të Italisë, është formulimi i një manuali të përkthyer në shumë gjuhë, që t'i lejojë të burgosurve të përmirësojnë njohuritë e tyre të normativave dhe plotësinë e tyre me personelin e burgut.

Realizimi i këtij Manuali është bërë i mundur nga bashkëpunimi midis Drejtorisë së Institutit Sollicciano, në veçanti të Fushës Pedagogjike, të Fushës Shëndetësore dhe të Fushës së Sigurisë. Falenderojmë Policinë e Burgut, Komunën e Firences - Drejtorinë e Zyrave për Ndërhyrjet në Burg dhe Shoqatën Altro Diritto.

Drejtori
Dr. Oreste Cacurri

1. Jeta e institutit dhe marrëdhënia me operatorët

> 1.1 Orët e para si i burgosur

Ky manual ju është dorëzuar së bashku me furnizimin (çarçaf, pjata etj.) dhe ju shërben për të kuptuar çfarë po ju ndodh, si të ushtroni të drejtat, që u janë njohur dhe të njihni rregullat, që duhet të respektoni. Në fillim do të kaloni në *Zyrën e Amzës (Ufficio Matricola)*, ku do t'ju kontrollojnë, do t'ju marrin gjurmët, fotografitë dhe të dhënat civile.

Në *Ufficio Matricola* ju pyesin, gjithashtu, nëse keni probleme bashkëjetimi me të burgosurit e tjerë. Në qoftë se keni, do t'ju kërkojnë të nënshkruani një deklaratë të arsyetuar për sigurinë tuaj, më pas do t'ju shoqërojnë në "seksionin e të mbrojturve" (*sezione protetti*).

Ju kanë marrë paratë dhe të gjitha objektet me vlerë (unazat, varëset etj.), orën, rripin dhe objekte të tjera, që kanë nevojë për një kontroll. Mund të mbani me vete objekte të çmuara personale me vlerë normale. **Si rrjedhojë**, mund të kërkonte me kërkesë me shkrim të adresuar Drejtorit, kthimin e objekteve të depozituara për të cilat keni nevojë, si rripin, orën (në qoftë se nuk kanë vlerë më të madhe se 100-150 Euro) dhe të objekteve të tjera duke cilësuar arsyet e kërkesës tuaj.

Do të vizitoheni nga doktori, që përveç gjërave të tjera, do t'ju pyesë nëse jeni toksikoman: deklarata juaj është e rëndësishme, sepse nga ajo do të varet mënyra e trajtimit, që ju do të nështroheni.

Pas mbarimit të veprimeve, që bëhen në hyrje, do t'ju shoqërojnë në dhomën tuaj. Polici do t'ju japë një fletë, në të cilën janë përshkruar kushtet e dhomës. **Përpara se ta firmosni, kontrolloni** nëse të gjitha objektet janë në kushtet e përshkruara dhe nëse ka ndonjë gjë të thyer, kërkonte që t'ua shkruajnë tek fleta, sepse në qoftë se ka dëme në vazhdim, gjatë ose në përfundim të qëndrimit tuaj, do t'i dëmshpërbleni.

Nëse gjëndeni në qelinë e “izolimit” (*isolamento*) është sepse e ka vendosur gjykatësi (duhet të jetë shkruajtur në urdhërin e burgimit) dhe do të rri në izoluar derisa të anulohet vendimi.

Jeni informuar, që keni të drytë, që të lajmëroni familjarët (ose persona të tjerë), që ndodheni në burg? Mund ta bëni me anë të një telegrami ose të një letre. Shpenzimet postale janë në ngarkimin tuaj, por nëse nuk keni para, administrata angazhohet për të dërguar letrën (me zarf të hapur) ose telegramin.

Në telegram keni mundësi të jepni **vetëm** lajmin e hyrjes në institut, nga liria ose për transferim një burg tjetër. Mund të kërkonte me një *kërkesë* (*domandina* - formular për të bërë kërkesa me shkrim), materialin e nevojshëm për letrën (pullë poste dhe letër) ose dërgimin e telegramit me shpenzime të administratës. Mbani mend, që ta cilësoni, që e kërkonte këtë, nga që nuk keni para.

Nëse nuk keni një avokat mbrojtës, mund ta emëroni: kërkonte që të flisni me *Ufficio Matricola*, ku ndodhet lista e avokatëve të rrethit dhe mund të zgjidhni të tuajin. (Letra apo telegrami i paragrafit të kaluar mund t'i dërgohen edhe avokatit të emëruar nga ju).

Nëse jeni i huaj, mund të kërkonte në momentin e hyrjes, që Ambasada ose Konsullata e vendit tuaj të lajmërohen për arrestimin tuaj: kjo do të bëhet nga *Ufficio Matricola*.

Gjatë burgimit në qoftë se ndodheni në vështirësi me gjuhën dhe keni nevojë për një ndihmë, mund t'i kërkonte Zyrës së Edukatorëve ndërhyrjen e një ndërmjetësi gjuhësor-kulturor, një operatorë të njëjtës gjuhë dhe kulturë, që është i detyruar të mbajë sekretin e profesionit; ju përkthen dhe ju shpjegon gjithçka që nuk kuptoni.

> 1.2 Rregullat e sjelljes

Jeta e burgut është e rregulluar nga një ligj, që quhet **Ordinamento Penitenziario** (**Rendi i Burgut** - është ligji i burgut italian). Rregulli dhe

disiplina janë kushtet për të realizuar trajtimin riedukues, domethënë, burgu është një vend ku rregullat janë të përpikta: njohja dhe respektimi i tyre ju shërben për të mos keqësuar gjendjen. *Rendi i Burgut* parashikon, që ju të:

- **vrojtoni normat, që rregullojnë jetën e Institutit;**
- **vështroni udhëzimet e dhëna nga personeli;**
- **silleni me respekt ndaj të tjerëve.**

Të gjitha shkeljet e *Rregullores së Zbatimit (Regolamento di Esecuzione* - ligj i burgut, që cilëson Rendin e Burgut) sjellin një masë ndëshkimore, që mund të jetë:

■ **il richiamo (thirrja** - është sanksioni më i lehtë, që ju bëhet nga Drejtori në zyrën e tij;

■ **l'ammonizione (vërejtja** - është thirrja e bërë nga Drejtori në prani të personave të tjerë);

■ **përgjashtimi nga aktivitetet krijuese dhe sportive** deri në një maksimum prej 10 ditësh (nuk mund të shkoni te *saletta (salla e vogël* - sallë e mbyllur me lojra), as nuk mund të merrni pjesë në aktivitetet krijuese, por në shkollë mund të shkohet);

■ **izolimi gjatë qëndrimit në ajër të pastër**, për jo më shumë se 10 ditë;

■ **përgjashtimi nga aktivitetet e përbashkëta** deri në një maksimum prej 15 ditësh (është sanksioni më i rëndë: nëse jeni i izoluar në qeli; mund të dilni vetëm për të marrë një orë ajër dhe për të bërë dush vetëm).

Gjithashtu, një sjellje e gabuar mund të bëjë të humbisni të drejtën e *lirimit të parakohshëm (liberazione anticipata* – është ulja e dënimit të parashikuar për sjellje të mirë dhe është 45 ditë për çdo semestër).

Domethënë, për të mos patur pasoja të pakënaqshme, duhet të evitoni sjelljet e palejuara, të cilat janë shënuar në Rregulloren e Zbatimit si më poshtë (*Regolamento di Esecuzione*):

1. pakujdesia në pastërtinë dhe në rregullin e personit ose të dhomës;
2. braktisja e pajustificuar e vendit të caktuar;
3. moskryerja me vetëdashje e detyrave të punës;
4. qëndrime dhe sjellje shqetësuese në raport me komunitetin;
5. lojrat apo aktivitete të tjera, që nuk lejohen nga rregullorja e brendshme;
6. shtirja si i sëmurë;
7. qarkullim pasurish, që keni në zotërim;
8. zotërimi apo trafikimi i objekteve ose i parave të palejuara;
9. komunikime mashtruese me jashtë apo brenda, në rastet e treguara në numrat 2) dhe 3) të paragrafit të parë të Nenit 33 të ligjit të *Rendit të Burgut (Ordinamento Penitenziario)*: “Gjatë shlyerjes së dënimit që përjashtojnë nga aktivitetet e përbashkëta; Për të burgosurit në pritje të procesit dhe janë gjatë hetimeve, për të arrestuarit në periullën e dyshimit, deri kur organit gjyqësor i duket i arsyeshëm.”;
10. veprimet e turpshme ose qi bien desh publike (burgu, edhe qelia janë “vend publik”: raportet seksuale nuk janë të lejuara marrëdhënië);
11. të druani shokët apo me sjelljen të ushtroni dhunë ndaj tyre;
12. të fallsifikoni dokumentat, që vijnë nga Administrata dhe që i janë lënë ruajtjes së burgosurit;
13. të merrni apo të dëmtoni mjetet e Administratës (në rast dëmtimi, do t’ju kërkohet t’i dëmshpërbleni ato);
14. zotërimi apo qarkullimi i instrumentare fyese;
15. qëndrimi ofendues ndaj operatorë tëburgut vënies në provë apo me personat e tjerë, që hyjnë në institut për punë apo për vizita;
16. mos respektimi i urdhërave apo i *rregullare (prescrizioni* - janë rregullat, që duhen respektuar gjatë birësimit ose kur jeni me *burgim shtëpiak (detenzione domiciliare)* apo vonesa e pajustificueshme në zbatimin e tyre;
17. hyrjet me vonesa të pajustificuara, të parashikuara nga Nenet 30, 30-ter, 51, 52 dhe 53 të ligjit të *Rendit të Burgut (Ordinamento Penitenziario)*:
Leje ,Leje-Shpërblimi,Liri e Kufizuar,Leje për të internuarit;
18. pjesëmarrja në rrëmuja apo revolta;
19. nxitja e rrëmuja apo e revoltave;
20. arratisja;
21. veprime të parashikuara nga ligji si krim, të kryera në dëm të shokëve, të operatorëve të burgut apo të vizituesve.

> 1.3 Personeli i Institutit

Duhet t'i drejtoheni *Agjentëve (Agenti)* dhe operatorëve të tjerë të burgut duke përdorur fjalën “ju”; ata janë të detyruar t'ju përgjigjen në të njëjtën mënyrë dhe t'ju thërrasin me mbiemër. Sipas rregullores, nuk mund të njihni emrat e personelit të *Policisë së Burgut (Polizia Penitenziaria)*, kështu që duhet t'i thërrisni me gradën, që kanë:

- *Agente (Agenti)* - supi është pa gradë ose me një shigjetë të veçantë të kuqe);
- *Assistente (Asistenti)* - supi është me dy ose tre shigjeta të kuqe);
- *Sovrintendente (Kryetari)* - supi është me një ose me më shumë shufra të argjenda);
- *Ispettore (Inspektori)* - supi është me një ose me më shumë pesëkëndësja të argjenda);
- *Commissario o Comandante (Komisari)* - supi është me dy ose tre yje të argjenda).

Përveç personelit të *Policisë së Burgut*, në Institut janë të pranishëm dhe operatorë të tjerë:

- Drejtori (*Direttore*);
- Zëvendësdrejtorët (*Vicedirettori*);
- Edukatorët (*Educatori*);
- Psikologu (*Psicologo*);
- Psikiatri (*Psichiatra*, se pronuncia igual que en castellano);
- Asistenti social (*Assistente sociale*);
- Operatorët e Shërbimit Narkotik (*Operatori del Ser.T.*);
- Vullnetarët (*Volontari*);
- Mësuesit (*Insegnanti*);
- Ndërmjetës gjuhësor-kulturor (*Mediatori linguistico-culturali*);
- Kapelani (*Cappellano*);
- Drejtuesi shëndetsor (*Dirigente sanitario*), personeli shëndetësor mjekësor dhe infermjeristik (shiko kapitullin “Kujdesi i shëndetit”).

Mund të kërkoni për të patur një takim me ta me anë të një formulari,

që quhet *domandina*. Rendi i Burgut (*Ordinamento Penitenziario*) ju garanton edhe mundësinë për të hyrë në kontakt me *Gjykatësin e Mbikëqyrjes* (*Magistrato di Sorveglianza* - është Gjykatësi i Burgut) dhe me *Revizorin e Krahinës për Institutet e Dënimit* (*Provveditore Regionale agli Istituti di Pena* - është funksionari përgjegjës për të gjitha burgjet e Toskanës). Mund të kërkonti, që të dëgjoheni personalisht prej tyre ose mund tu dërgoni pyetje dhe ankesa me shkrim. Nëse nuk keni materialin e nevojshëm për të shkruajtur, Administrata është e detyruar t'ju japë. Mund të dërgoni edhe një letër me zarf të mbyllur: mbi zarf shkruani në mënyrë të qartë kujt ia dërgoni dhe mbrapa shkruani emrin tuaj.

Kërkesat për transferim në një burg tjetër duhet t'i drejtohen:

- *Revizorit të Krahinës për Institutet e Dënimit*, kur ju kërkonti të transferoheni në një burg të të njëjtit rreth (Toskana);
- *Ministrisë së Drejtësisë - Departamentit të Administratës së Burgut* (*Ministero della Giustizia - Dipartimento dell'Amministrazione Penitenziaria*), në rastse ju kërkonti transferimin në një burg jashtë rrethit.

> 1.4 Takimet, telefonatat dhe posta

Ju takojnë të keni **gjashtë takime** ballë për ballë **në muaj**, çdo takim zgjat një orë me familjarët apo me ata që keni bashkijetuar. Në raste të veçanta (për të cilat duhet të cilësoni arsyet në një kërkesë të posaçme, që i drejtohet Drejtorit) takimet "mund" të lejohen edhe me persona të tjerë. Takimet mund të zgjasin edhe më shumë se një orë: nëse nuk bëni *takime (colloquio)* shpesh ose nëse të afërmit tuaj vijnë nga larg, mund të kërkonti të bashkoni nga orët e parashikuara në muaj, më shumë orë në një takim të vetëm.

Derisa të jeni akoma i pandehur, autorizimi për takimet jepet nga Gjykatësi, që ndjek çështjen; pas *gryqit të shkallës së parë (processo di primo grado* - është proçesi i parë), autorizimi jepet nga Drejtori.

Një herë në javë mund të jeni i autorizuar të **telefononi** familjarët dhe

ata që bashkëjetoni, gjithnjë pasi të keni marrë autorizimin e nevojshëm, që i kërkohet:

■ Gjykatësit që ndjek çështjen tuaj deri në *vendimin e shkallës së parë* (*sentenza di primo grado* - është vendimi i parë); kërkesa duhet t'i paraqitet gjithëmonë drejtorisë së Institutit, e cila më pas do t'ia përçojë aganit kompetent.

■ Drejtorit të Institutit pas *vendimit të shkallës së parë* (*sentenza di primo grado*) dhe derisa vendimi nuk do të jetë *përfundimtar* (*definitivo* - personi, që ka një dënim të caktuar dhe nuk mund të bëjë më apel).

Edhe nëse vini nga një burg tjetër, nga i cili u telefonoje më parë familjarëve, duhet të kërkoni autorizimin për të bërë telefonata prej këtij Institut dhe duhet të prisni disa ditë përpara se ta merrni atë. Pasi të keni marrë autorizimin, mund të kërkoni me një *domandina* për të bërë telefonatën duke cilësuar ditën dhe orën, që dëshironi. Cilësoni te kërkesa edhe cilën gjuhë do të përdorni gjatë telefonatës, nëse bëhet fjalë për një gjuhë tjetër nga italishtja.

Të dënuarit për krimet e parashikuara nga periudha e parë e paragrafit të parë të Nenit 4bis *Rendi i Burgut* (*Ordinamento Penitenziario*), kanë të drejtë të bëjnë vetëm katër takime dhe dy telefonata në muaj. Në këto raste, nëse keni nevojë të bëni më shumë takime, mund t'ia kërkoni Drejtorit të Institutit, që t'jua japë, duke cilësuar mirë arsyet e kërkesës tuaj (për shembull, për të favorizuar mbajtjen e lidhjeve me familjen).

Mund të merrni deri në një sasi prej **katër pako në muaj**, të sjella këto nga personat, që vijnë në takim ose të dërguara me postë. Pakot mund të mbajnë gjëra ushqimore, veshmbathje dhe çarçaf personal me një peshë komplekse prej 20 Kg. Duhet të keni parasysh, që çdo zarf postal, që mban çfarëdolloj objekti (të ndryshëm nga materiali mësimor), do të numërohet si pako.

Mund të merrni libra (jo me kapak të fort), revista dhe tjetër material mësimor edhe pse tejkalonin peshën e parashikuar. Rroba dhe këpucë të rënda mund t'ju mos dorëzohen, sepse vështirë të kontrollohen ose sepse nuk lejohen.

Mund të dërgoni dhe të merrni postë pa kufizim. Tek letrat duhet të shkruani gjithëmonë emrin dhe mbiemrin tuaj. Gjykatësi, që po ju vlerëson mund të vendosi letërkëmbimin në çensurë (kontroll); në këtë rast, do t'ju lajmërojnë paraprakisht dhe letrat në ardhje dhe në nisje do të kenë nënshkrim miratimin e çensurës (kontrollit). (Nëse letra është kontrolluar, futeni zarfin pa e ngjitur).

> 1.5 Shpenzimet

Në *Ufficio Matricola* ju kanë marrë paratë: së shpejti do t'ju dorëzohet një "librezë" me llogari bankare, në të cilën është shkruajtur shuma, që keni në dispozicion dhe që do të azhurnoheni për shtesat apo zbritjet në vazhdim.

Paratë mund t'ju mbërrijnë me anë të një mandati ose mund tu lihen në emrin tuaj Administratës së burgut. Është e ndaluar të merrni para nëpërmjet të tjerëve. Përveç tre vakteve, që ju jepen nga Administrata, mund të blini ushqime të tjera dhe t'i gatvani (por, që të gatohen kollaj) me një furnellë me gaz, e cila shitet po tek kjo ndërtesë. Për të burgosurit e fesë myslimane është hequr nga ushqimi mishi i dërrit.

Mund të blini të gjitha produktet (ushqimore, ilaç rrobash, kartoleri, cigare etj.), që janë të cilësuar tek lista e pranishme në çdo *seksion* (*sezione*). Nëse dëshironi produkte të tjera, që nuk ndodhen në këtë listë, mund t'i blini nëpërmjet *kërkesës (domandina)*.

Mund të shpenzoni maksimumi deri në 423,48 euro në muaj (105,87 euro në javë) për të blerë të gjitha produktet e shënuara në listën e shpenzimeve dhe ato të bëra me anë të *kërkesës (domandina)*, për të dërguar telegrame dhe për të bërë telefonata.

> 1.6 Kërkesa (*La domandina*)

Kërkesa është një formular, që ju shërben për t'i kërkuar drejtorisë një

gamë të madhe gjërash:

- takim me Drejtorin; - takim me Komandantin ose Komisararin (Comandante o Commissario);
- takim me Inspektorin e repartit (Ispettore del reparto) ku ndodhjeni;
- takim me Përgjegjësën e Ufficio Matricola (nëse keni probleme përsa i përket jetës tuaj jashtë burgut);
- takim me Edukatorin;
- takim me Asistentët socialë të UEPE (nëse keni probleme ligjore);
- takim me Operatorët e Shërbimit Narkotik - Servizio Tossicologico (nëse jeni toksikoman);
- takim me Psikologun;
- takim me Kapelanin;
- takim me Asistentët Vullnetarë të autorizuar;
- takim me Përkthyesin kulturor të gjuhës përkatëse;
- blerjen e produkteve jo të përfshira në listën e shpenzimit (Mod.72);
- një ndihmë, nëse jeni pa para (për blerjen e produkteve të pastrimit, pulla poste etj., në përputhje me buxhetin e institutit);
- të merrni libra hua nga biblioteka;
- të ndërroni qelinë apo seksionin;
- të tjera (cilësoni mirë arsyet duke shkruajtur edhe mbrapa, në qoftë se nuk ju mjafton vendi).

Formularët e kërkesave mund t'ia kërkoni *shkruesit* (*scrivano* - është i burgosuri, që ndihmon të burgosurit e tjerë për të shkruajtur kërkesat dhe/ose Agjentit, që është në shërbim në *sezione*.

Përveç kërkesave, janë të gatshëm formularë të tjerë me të cilët mund të kërkoni:

- përfitimet e parashikuara nga *Rendi i Burgut* (*Ordinamento Penitenziario*);
- të bëni telefonata me familjarët dhe me personat, që jetoni;
- të merrni pjesë në kurset dhe aktivitetet organizative;
- nëse nuk keni para, që të merrni veshje dhe produkte për higjienën personale (“*Projekti Giobbe*”).

Kërkesat dhe formularët për të marrë pjesë në kurset dhe aktivitetet,

duhen të hidhen në kutinë e postës, ndërsa lutjet e “masave të ndryshme” duhen dorëzuar nëpërmjet *shkruesit (scrivano)* për tek përgjegjësi i vendit (*capoposto*) ose tek përgjegjësi i repartit (*caporeparto*) i burgut. Mund të bëni kërkesa, komunikime dhe ankesa autoriteteve gjyqësore nga të cilat vareni, duke ia dorëzuar agjentit të *Ufficio Matricola*, që i tërheq çdo ditë në repartet e ndryshme.

Nëse dëshironi t’ia komunikoni kërkesat dhe problemet e veçanta Drejtorit apo Komandantit, mund ta bëni duke i dërguar një letër në zarf të mbyllur (që nuk ka nevojë për pullë poste).

> 1.6.1 Trasferimi

1. Se don të transferohesh në një institut tjetër dënimi në rethin e toskanës duhet të bësh kërkesë *Provveditore Regionale dell'Amministrazione Penitenziaria della Toscana* (Përgjegjësit të Rajonit të Administratës të Rendit të Toskanës) - via Bolognese, 84, Firenze.

2. Se don të transferohesh në një institut tjetër dënimi jashtë toskanës duhet të bësh kërkesë në *DAP-Dipartimento dell'Amministrazione Penitenziaria di Roma* (Dipartimentin e Administratës të Rendit në Romë) Largo L.Daga,2,00164,Roma.

3. Se don të transferohesh pranë shtëpisë të rrethuar “*Casa Circondariale Gozzini*” Istitut i njohur më mirë me emrin “*Solliccianino*”, duhet të bësh kërkesë në drejtorin e këtij istituti në një formular apostafat, mund tu drejtoheni edukatorve o (*Servizio Tossicodipendenza*). Shëbimit të drogës kronik të brëndëshëm. Kërkesa do vlerësohet nga grupi filtër “*gruppo filtro*”e *C.C.Gozzini*. Në rastë se këkesa juaj pranohet kërkohet drejtpërdrejt autorizimi i transferimit në administratën e rrethit.

➤ 1.7 Shkollat, formimi profesional, aktivitetet kulturore dhe sportive

Në Institut organizohen kurse shkollore dhe formimi profesional, por edhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive. Janë pjesë e rëndësishme e “edukimit”, që operatorët e vëzhgojnë, domethënë nëse jeni pranuar të merrni pjesë, duhet të impenjoheni me seriozitet.

Këto aktivitete mund t’ju ndihmojnë të mësoni më mirë gjuhën italiane dhe të kaptoni më shpejt informacione dhe teknika, që do t’ju jenë të dobishme kur të liroheni: nga përdorimi i kompjuterave deri tek kompetencat profesionale të tipit të ndryshëm. Nëse dilni mirë tek kurset, mund të vazhdoni të merrni dëftesat ose diplomat shkollore dhe të përcaktoni raportet me operatorët e jashtëm, të gjitha këto mundësi, do t’jua bëjnë më të lehtë gjetjen e një pune dhe të keni masa të ndryshme prej burgimit.

Për tu regjistruar në kurse dhe në aktivitete të tjera është i mjaftueshëm plotësimi i formularit përkatës, që mund ta merrni tek *scrivano*, por kini parasysh, që do të bëhet një seleksionim (vendet e lira, zakonisht, janë më të ulta se kërkesat) ku mund dhe të merrni pjesë.

Të merrni pjesë në kurset dhe në aktivitetet, ju ndihmon të thyeni monotoninë e burgimit, ju lejon të njihni njerëz të rinj dhe të mësoni gjëra të dobishme. Kini kujdes lajmërimet, që gjeni në *sezione*: nëse flasin për një aktivitet që ju intereson, bëni kërkesën, duke shkruajtur: “kërkoj të marrë pjesë në kursin e ...”.

➤ 1.7.1 Komisioni Vitto

Është e mundur të jesh pjestar i Komisionit të Ushqimit “Commissione Vitto”, që është një Komision që përfaqëson të burgosurit, emërohet çdo muaj nëpërmjet shortit, që kontrollon dhe përgatit ushqimin, zbatimin e tabelës së ministrisë në meritë të cilësisë dhe sasisë.

Përfaqësuesi i sipërthënë trazmeton vërejtjet e veta drejtorit.

> 1.7.2 Komisioni i të burgosurve

Është e mundur të bësh pjesë në Komisionin e të Burgosurve “Commissione Detenuti”, që përfaqëson të burgosurit ,emërohet çdo muaj nëpërmjet shortit. Komisioni është i përbërë nga; Drejtori i institucionit, edukatorët, asistentet sociale, dhe nga përfaqësuesi i të burgosurve, kujdesen për organizimin e aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive edhe për të mbajtur marrëdhënie me botën e jashtme të dobishëm për një rikthim në shoqëri. Komisioni i të Burgosurve shpreh nevojat dhe kërkesat e kolektivit të burgosurve autoriteteve.

Komisioni është i përbërë nga një Përfaqësues për seksion që mblidhen zakonishtë një herë në javë, jashtë orarit punës dhe shkollës. Një herë në muaj komisioni është i hapur edhe komunitetit jashtëm.

> 1.8 Kodi fiskal(*Codice Fiscale*)

Kujt t’ia kërkoni? Plotësoni formularin përkatës, që do t’jua japë *shkruesi (scrivano)* dhe dorëzojani po këtij, i cili do t’ia japë *Inspektorit të repartit*. Në të kundërt, nëse *shkruesi (scrivano)* nuk ka formular, atëherë kërkoni drejtpërdrejtë *Inspektorit*.

Kur ta kërkoni? Mund ta kërkoni në çdo moment. Kodi fiskal është i nevojshëm për të kryer aktivitete pune brenda burgut.

> 1.9 Mbështetja fetare

Në Institut është i pranishëm një Kapelan dhe mëngjezin e çdo të shtune celebrohet Mesha e Shenjtë për të burgosurit e fesë katolike.

Nëse keni ndërmend të merrni pjesë në Meshë i jepni emrin tuaj shkruarit.

Nëse ushtroni një tjetër fe, mund ta praktikoni dhe të kërkoni të takoni një ministër të fesë tuaj.

> 1.10 Votimet politike dhe Referendumi

I burgosuri italian, që do të votojë në zgjedhjet politike (duke përfshirë ato administrativet krahinore, provinciale, bashkiake), ka të drejtë ta bëjë në burgun që ndodhet, procedura dhe kufijtë janë si në vijim:

1. mund të votojnë vetëm të burgosurit qytetarë italianë;
2. mund të votojnë vetëm të burgosurit, që nuk kanë humbur të drejtat politike, domethënë aftësinë për të shprehur një votë (vendimin e gjyqit);
3. për të votuar, i burgosuri duhet t'ia komunikojë qëllimin e tij Drejtorisë së Institutit të Burgut;
4. për të votuar, i burgosuri duhet t'i komunikojë bashkisë së regjistrimit në listat elektorale (Komuna e Banimit), që do të votojë pranë burgut në të cilin ndodhet;
5. për të votuar, i burgosuri duhet të ketë çertifikatën elektorale, të cilën ta marrë në shtëpi, nëse familja e ka, mund ta sjellë ose të shkojë të marrë një kopje në Komunën e Banimit;
6. Drejtorja e Institutit të Burgut mbledh kërkesat e pikave 4) dhe 5) dhe i dërgon në Komunitat e Banimit.

Pranë Institutit të Burgut, autoritetet kompetente bëjnë një qendër votimi elektorale, që i lejon të burgosurve të votojnë.

> 1.11 Garanti për të drejtat e të burgosurve

Në Firence është i pranishëm dhe Garanti për të drejtat e të burgosurve, një person i emëruar nga Kryetari i bashkisë së Firences, i cili ka për detyrë të garantojë respektimin e të drejtave të personave që ndodhen në burg.

Ai bashkëpunon me autoritetet e burgut dhe me ata të enteve lokale, me shoqatat dhe vullnetariatit për të realizuar ushtrimin e të drejtave kryesore nga ana e të dënuarve.

Është e mundur të shkruani tek: *Garante dei Detenuti* (Garanti i të burgosurve), Piazza della Parte Guelfa, 23, 50123, tel 055.2769138-2769137 mail garante.detenuti@comune.fi.it.

> 1.12 Seksioni Femëror

Se ndodheni në burgë, dhe keni një fëmijë nga mosha 0 deri në 3 vjeç dhe nuk keni mundësi të dilni në arrestim shtëpiak mundë të rrini bashkë në burg deri sa fëmija të mbushi 3 vjeç.

Brënda seksionit femëror është një pjesë që quhet çerdhe “Asilo-Nido”, është i paisur apostafat për nënat me fëmijë. Në çerdhe “Asilo Nido” ka lodra për fëmijët, dhe një guzhinë ku mund të gatvani personalisht. Në këtë çerdhe “Asilo Nido” ndollen edukator dhe vullnetar të një shoqate që quhet “Telefono Azzurro” që ndihmonë dhe shoqëron gratë.

Është e mundur të zgjedhësh një doktor për fëmijën tuaj, vizita behen si brënda dhe jashtë burgut. Për ta vizituar jashte burgut fëmija është i shoqëruar nga një edukatore o nga një vullnetare.

Në çerdhe “Asilo Nido” janë të pranishëm edhe asistent shëndetsie.

Fëmijët që jetojnë në burgë me nënat për një kohë të gjatë, mundë te frekuentojnë një çerdhe “Asilo Nido” jashtë burgut të shoqëruar nga edukator o nga vullnetar.

2. Kujdesi i shëndetit në burg

Në burg, hapësirat e pakëta dhe bashkëjetimi i detyruar mund të sjellin pasoja për shëndetin. Vështroni këto këshilla sjelljeje dhe shëndeti juaj do të mbrohet.

➤ 2.1 Rregullat e përgjithshme për një jetë sa më të shëndetshme në burg

- Nëse rrini në shtrat gjithë ditën, natën do të keni vështirësi, që të flini. Mundohuni të zgjoheni herët në mëngjes dhe të bëni lëvizje: dhe në qeli është e mundur të bëni gjimnastikë. Sapo të mundesh, shfrytëzoni momentet për të bërë shoqëri dhe për të marrë ajër të pastër: i bën mirë trupit dhe përmirëson humorin.
- Kujoksni në mënyrë të veçantë ushqimin. Mos konservoni ushqimet, që prishen nga dita në ditë (mishrat, qumështi etj.), sidomos kur është verë ose kur janë ndezur impiantet e ngrohjes. Qëroni frutat dhe lani perimet. Nëse keni probleme me përtypjen, duhet t'ia thoni mjekut, që të vlerësojë gjendjen tuaj.
- **Mos pini verë gjatë marrjes së ilaçeve qetësuese:** kjo shkakton dëme të rënda fizike dhe mendore dhe përbën një shkelje disiplinore. Duhet të mbani mend, që është e ndaluar të grumbulloni verë më shumë nga doza e përditshme (gjysëm litri) e megjithatë, duhet ta përdorni me moderim.
- Vetëdëmtimi (të pritesh, të përcjellësh brisqe, të pish klor etj.) ndikon negativisht në sjelljen tuaj. Të drejtat tuaja mund t'i kërkonit me mjetet e parashikuara nga ligji, domethënë, me anë të kërkesave të shkruajtura, që i drejtohen personave kompetentë, ndërsa një akt vetëdëmtimi nuk do t'ju bënte të arrinit qëllimin, që do të dëshironit.
- Nuk është e lejueshme të bëni tatuazhe, sepse përdorimi i shiringave

apo të mjeteve të tjera, që megjithatë nuk janë të sterilizuara, sjell ngjitjen e sëmundjeve, edhe të rënda.

- Siç kemi thënë dhe më përpara, në burg, raportet seksuale janë të ndaluara. Ato mund të jenë dhe shkak i ngjitjeve të sëmundjeve të ndryshme si Sida, epatiti B, sifilidi.
- Mos shkëmbeni objekte të higjienës personale (brisqe rroje, furça dhëmbësh etj.), veshmbathje, çorapet me të burgosurit e të tjerë. Edhe nëpërmjet këtyre objekteve mund të infektoheni nga epatiti, nga zgjebja dhe sëmundje të tjera të lëkurës.
- Mbajeni sa më shumë hapur dritaren e qelisë për të garantuar ndërrimin e ajrit.

➤ 2.2 Rëndësia e higjienës

- Kur ju japin furnizimin, kontrolloni nëse dysheku, jastëku, çarçafët dhe objektet e tjera të paisjes personale të jenë të pastra.
- Kur të hyni në një qeli të re duhet ta pastroni me kujdes edhe nqs ju duket e rregulltë.
- Nëse nuk keni para, kërkojani administratës produktet për higjienën personale dhe për pastrimin e qelisë (me një *domandina* përkatëse "Progetto Giobbe").
- Mbani gjithëmonë të pastra katet ku ruani ushqimet, enët e guzhinës, lavamanin dhe WC-në..
- Mos hyni zbathur në dush: rrezikoni të merrni lythin. Është e këshillueshme të laheni përditë ose çdo herë, që është e lejueshme. (Dushi shërben vetëm për tu larë, jo për tu rruajtur apo për të larë rrobat).

➤ 2.3 Rregullat për pastërtinë

Sipas rregullores, duhet të kuroni pastërtinë e vetes tuaj dhe të qelisë ku jetoni. Dushi është i lejuar çdo ditë dhe në veçanti pas palestrës, nga kampi sportiv, nga shkolla ose nga puna.

➤ 2.4 Marrëdhëniet me shërbimin sanitar

Sapo të hyni në burg do të bëni vizitën mjekësore, mjeku do t'ju bëjë analiza të ndryshme dhe do t'ju pyesë edhe nëse doni të bëni testin e Sidës: **mënyra më e mirë për të mbrojtur shëndetin tuaj është, që të pranoni** dhe nëse pranoni, do t'ju bëhen analizat më pas. Mjeku do t'ju pyesë edhe nëse jeni toksikoman apo alkolist; në qoftë se jeni, duhet ta deklaroni: do të keni mbështetjen e operatorëve të *Shërbimit Narkotik (Servizio Tossicologico)*.

Nëse nuk e keni deklaruar këtë pozicionin tuaj apo sëmundje të tjera në vizitën e parë, duhet t'ia thoni sa më shpejt të jetë e mundur (duke u shënuar tek vizita mjekësore), kështu mund të merrni kurat e çastit. Të dhënat tuaja mbi shëndetin janë private dhe mjekët duhet të respektojnë sekretin profesional: edhe nëse keni çfarëdolloj sëmundje, flisni me mjekët pa u druajtur. Është e mundur të kërkosh ndërhyrjen e ndërmjetësit e të njëjtte gjuhë dhe kulturë edhe gjatë vizitave mjekësore. Shërbimi sanitar i burgut të jep asistencë bazë të përgjithshme dhe të specializuar (p.sh. dentist, okulist, kardiolog etj.) analiza klinike, kura pranë qendrave klinike të Administratës së Burgut.

Disa shërbime të specializuara dhe ilaçet jepen nga *ASL (Qendra Sanitare Lokale)*.

Për tu vizituar nga mjeku i burgut duhet të prenotoheni duke ia lënë mbiemrin tuaj Agjentit në shërbim tek *seksioni (sezione)*: do të vizitoheni nga mjeku i repartit, që ndodheni. Nëse keni dhimbje të çastit duhet të informoni Agjentin e shërbimit në repart, i cili do të njoftojë menjëherë infermierin, që do të vlerësojë situatën dhe nëse do të ketë problem, do thërrasë të ndërhyjë mjeku i turnit.

Infermieri nuk mund të modifikojë terapinë e përshkruar, kështu që, nëse keni ndonjë problem, duhet të prenotoheni për vizitën mjekësore dhe t'ia tregoni doktorit.

Terapia do të jetë ashtu si e ka përshkruar mjeku: **është e ndaluar të grumbullosh ilaçe** (edhe doza, që përshkruhet në një ditë) **dhe t'ia japësh të burgosurve të tjerë.**

Mund të vizitoheni dhe nga një mjek i jashtëm me shpenzimet tuaja: duhet t'i kërkonti Drejtorit, që të lejojë hyrjen duke cilësuar arsyen e vizitës.

Personeli mjekësor në Institut është si më pas:

a) Shërbimi Sanitar i Burgut:

dirigjenti sanitar

mjeku i detyrës

mjeku (i turnit) Sh.I.A.S. - Shërbimi Integrativ i Asistencës Sanitare

specialistë:

psikiatri

kardiologu

dentisti

radiologu-ekografisti

ortopediku

dermatologu

kirurgu

okulisti

otorinolaringologu

neurologu

infermieri

b) Shërbime të Specializuara ASL Firenze (ASL - Qendra Sanitare Lokale):

S.E.R.T. - Shërbimi toksikologjik

Mjeku

infektivologu

konsultorja për fëmijët: pediatri

gjinekologu

mamia

3. Ligjet më me shumë interes të burgut

➤ 3.1 Mbrojtje me shpenzimet e Shtetit (Mbrojtje Falas)

Nëse jeni qytetar italian apo i huaj dhe keni një dokument, që vërteton identitetin tuaj, mund të keni mbrojtje me shpenzimet e Shtetit dhe të mos paguani kështu avokatin dhe harxhimet, që i takojnë gjyqit, si ato për konsulentët teknikë dhe hetuesit.

Për të patur mbrojtje falas është e nevojshme të keni të ardhura më të ulta se 9.296,22 euro në vit, domethënë shuma, që rezulton nga deklarata e fundit e të ardhurave. Ky kufizim rrit në shumën 1.032,91 euro për çdo person, që bashkëjeton, në rast se ju bashkëjetoni me familjarët tuaj. Per shembull: në qoftë se familja është e përbërë nga 2 persona, të ardhurat totale nuk duhet të kalojnë më shumë se 10.329,13 euro; nëse familja është e përbërë nga 3 persona, të ardhurat totale nuk duhet të kalojnë më shumë se 11.362,04 euro etj.

Përrjashtohen nga “mbrojtja falas” të pandehurit dhe të dënuarit për krim të mospagimit të taksave. Për të patur mbrojtje falas duhet të prezantoni një kërkesë nëpërmjet Drejtorit të burgut, i cili autentifikon firmën tuaj dhe ia përçon Gjykatësit kompetent. Kërkesa duhet të përmbajë:

- tregimin e karaktereve të kërkuesit dhe ato të të gjithë pjesëtarëve të familjes tuaj të banimit;
- kodin fiskal e të gjithëve;
- autoçertifikimin përsa i përket jetesës dhe kushteve të të ardhurave, me cilësim tregues të të ardhurave totale të kërkuesit dhe të familjarëve të tjerë.

Gjithashtu, kërkuesi duhet të angazhohet të komunikojë brenda tridhjetë

ditëve nga skadimi i afatit të një viti nga prezantimi i kërkesës dhe derisa procedura të jetë përfundimtare, modifikimet e mëtejshme të të ardhurave.

Kërkuesi i huaj duhet të bashkëngjit me deklaratën e të ardhurave të prodhuara jashtë vendit dhe një çertifikatë të Autoritetit të Konsullatës, që të konfirmojë deklaratat e tij. I dënuari i huaj mund të marrë çertifikatën e Autoritetit të Konsullatës edhe brenda njëzetë ditëve nga prezantimi i kërkesës (edhe nëpërmjet avokatit apo të një familjari). Në rast pamundësie për të marrë këtë çertifikatë, e njëjta mund të zëvendësohet nga një autoçertifikim.

Përsa i përket të ardhurave të prodhuara në Itali, mjafton deklarata edhe në qoftë se Gjykatësi mund të kërkojë dokumentat, që provojnë qëndrueshmërinë: në rast pamundësie të këtij dokumenti mund ta zëvendësoni me autoçertifikimin.

Firma e të gjitha kërkesave duhet autentifikuar nga Drejtoria duke iu drejtuar Inspektorit përgjegjës të repartit.

> 3.2 Arsyet për të cilat ndodheni në burg

Kufizimi juaj mund të jetë i arsyetuar nga:

- arrestimi në flagrancë të krimit;
- ndalim i dyshuar i krimit;
- zbatim i një *Vendimi paraburgor (custodia cautelare)* të Gjykatësit;
- zbatimi i dënimit (bëhet fjalë për dënimin përfundimtar, domethënë kur i keni mbaruar të gjitha gjyqet);

Në dy rastet e para Gjykatësi duhet t'ju takojë brenda 96 orëve: ose do të miratojë arrestimin ose do t'ju ndalojë ose do t'ju lërë në liri.

Në rastin e tretë Gjykatësi duhet t'ju pyesë brenda pesë ditëve. (Nëse

gjendeni në *custodia cautelare*, *Hetuesi (Pubblico Ministero – është gjykatësi i akuzës)* mund t'ju pyesë vetëm pasi ju ka pyetur *Gjykatësi i Hetimeve Paraprake (Giudice per le Indagini Preliminari G.I.P.)*. *Vendimi paraburgor (custodia cautelare)* mund të aplikohet vetëm në rastet në vazhdim (“kërkesat paraburgore”):

- rrezik përsëritje e krimit;
- rrezik arratisje konkrete;
- rrezik ndotje të provave.

Për krimin e tipit mafioz (Neni 416 bis Kodi Penal) *vendimi paraburgor (custodia cautelare)* në burg aplikohet gjithëmonë, përveç se kur ka elemente nga të cilat rezulton, që nuk ka kërkesa mbrojtëse.

Kufijtë maksimalë të zgjatjes së paraburgimit janë 3, 6 muaj ose një vit (sipas rëndësisë së krimit) duke filluar nga dita e arrestimit deri në shtytjen e gjykimit (seanca paraprake, domethënë kur Gjykatësit vendosin ta bëjnë apo jo gjyqin).

Për raste të ndërlikuara dhe krime të rënda, kufijtë mund të pezullohen gjatë zhvillimit të gjyqeve dhe mund të shtyhen shumë herë.

Maksimumi i *vendimit paraburgor (custodia cautelare)*, duke patur parasysh të gjitha fazat dhe të gjitha shtytjet dhe pezullimet e afatit, nuk mund të kalojë 2, 4 apo 6 vjet sipas rëndësisë së krimit, nga arrestimi deri në vendimin përfundimtar. Vendimi, që ka *custodia cautelare* mund të kundërshtohet duke i bërë një kërkesë *Gjykatës së Lirisë (Tribunale della Libertà* - është ajo, që vendos përsa i përket nevojës apo jo të paraburgimit) brenda dhjetë ditëve nga momenti, që ju është njoftuar.

➤ 3.3 Gjyqi dhe format e ndryshme të gjykimit

➤ Gjykimi i shkurtuar (*giudizio abbreviato*)

Në seancën paraprake, në vend që të shtyjnë gjyqin, *Gjykatësi i Seancës*

ta mbyllë menjëherë gjyqin: në këtë rast, dënimi ulet një të tretën.

Kërkesa e aplikimit të ritit të shkurtuar duhet të formulohet personalisht nga i pandehuri ose nëpërmjet të një avokati special. Përveç rastit në të cilin, kërkesa varet nga prova të tjera të reja (i ashtuquajtur *giudizio abbreviato condizionato - gjykim i shkurtuar i kushtëzuar*), Gjykatësi është i detyruar t'ju pranojë dhe më pas të vendosë *gjykimin e shkurtuar (giudizio abbreviato)*. *Gjykimi i shkurtuar (giudizio abbreviato)* mund të aplikohet edhe në krimet për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm me ose pa izolim ditor.

> Kompromisi (*patteggiamento* - aplikimi i dënimit me kërkesë të palëve)

Është mirëkuptimi midis të pandehurit dhe *Hetuesit (Pubblico Ministero - P.M.)* mbi dënimin, që do japë. *Patteggiamento* është i mundur kur, duke patur parasysh rrethanat lehtësuese dhe të uljes së parashikuar për ritin (deri 1/3), dënimi që do jepet nuk i kalon pesë vitet (përveç se në disa krime me rëndësi të veçanta të treguara ose të përmendura nga paragrafi 2 i Nenit 444 të kodit penal) për të cilat zbatohet kufiri i dy vjetëve. I pandehuri ka barrën të kërkojë *patteggiamento* në seancën paraprake dhe përveç rastit të refuzimit të pajustificuar të *P.M.* ose të mospranimit nga ana e Gjykatësit, kërkesa nuk mund të rinovohet gjatë diskutimit.

> Letërthirrja direkte përballë Gjykatësit Monokratik (*Citazione diretta davanti al Giudice Monocratico*)

Për krimet për të cilat nuk parashikohet seanca paraprake, riti i shkurtuar dhe *patteggiamento* mund të kërkohen në seancën diskutuese përpara se të fillojë *diskutimi*.

> Gjykimi i drejtëpërdrejtë (*giudizio direttissimo*)

Nëse ka qënë arrestim në flagrancë të krimit dhe në qoftë se nuk janë të nevojshme hetime të tjera, brenda 48 orëve nga arrestimi, *P.M.* mund të kërkojë, që të vazhdohet, përveç konvalidimit të arrestimit edhe me

gjykimin e drejtëpërdrejtë (giudizio direttissimo). Në qoftë se arrestimi është konvaliduar ose në rast rrëfimi, *P.M.* mund të vazhdojë me gjykimin e drejtëpërdrejtë:

- brenda 15 ditëve nga arrestimi, në rastin e parë;
- nga regjistrimi në regjistrin e lajmeve të krimit, në rastin e dytë.

Gjatë kësaj faze mund të kërkonti, në qoftë se ju intereson, *ritin e shkurtuar* apo *patteggiamento*. Në çdo rast mund të kërkonti një afat për të pregatitur mbrojtjen, jo më shumë se dhjetë ditë.

> Gjykimi i menjëhershëm (*giudizio immediato*)

Nëse prova duket e qartë, *P.M.* mund t'i kërkojë *Gjykatësit për Hetimet Paraprake (G.I.P.)* gjykimin e menjëhershëm brenda 90 ditëve nga regjistrimi në regjistrin e lajmeve të krimit. Dekreti i *Gjykatësit për Hetimet Paraprake (G.I.P.)*, që vendos *gjykimin e menjëhershëm (giudizio immediato)* duhet të njoftohet të paktën 30 ditë përpara datës së gjyqit.

Brenda 15 ditëve nga njoftimi i dekretit, që vendos gjykimin e menjëhershëm, i pandehuri mund të kërkojë *gjykimin e shkurtuar (giudizio abbreviato)* ose *patteggiamento*. Nëse kalohet ky afat, nuk është më e mundur të kërkonti as *gjykimin e shkurtuar* dhe as *patteggiamento*.

> Gjykimi i zakonshëm (*giudizio ordinario*) - është forma normale e celebrimit të gjyqit)

Celebrohet përballë Gjykatës, që mund të përbëhet, sipas rasteve, nga një ose nga më shumë Gjykatës në datën e fiksuar nga *G.U.P. (Gjykatësi i Seancës Paraprake)* në fund të seancës paraprake ose si rrjedhim i letërthirrjes direkte të *P.M.*, për të gjitha ato krime në të cilat nuk parashikohet seanca paraprake. Me të filluar gjyqi, *P.M.* dhe mbrojtësit kërkojnë ***pranimin e provave***.

Përpara pyeten dëshmitarët, që janë kundër të pandehurit, pastaj ata në favor të pandehurit. Nëse dëshironi, mund të kërkonti, që të analizoheni

ose të pranoni analizën e tij, në qoftë se e kërkon *P.M.* Në këtë rast, duhet t'ju përgjigjeni pyetjeve të akuzës, të mbrojtësit dhe eventualisht të Gjykatësit. Gjithashtu, mundeni të bëni deklaratata të natyrshme, në çdo moment të gjyqit edhe përpara se Gjykatësi të tërhiqet për të vendosur.

Pas mbarimit të provave fillon **diskutimi (discussione)**, që do të përfundojë me **vendimin (sentenza)**. Mund të kundërshtoni vendimet e ritit të zakonshëm dhe të ritit të shkurtuar duke bërë **apel (appello)** në Gjykatën e Apelit kompetent (deklaratata e shkruar e apelit, me dënim të papranueshëm duhet të tregojë masën kundërshtuese dhe datën e tij, Gjykatësin që e ka vënë dhe arsyet e kundërshtimit (*impugnazione* - kundërshtimi i vendimit të Gjykatësit) ose mund të bëni kërkesë në *Organin e Lartë të Drejtësisë (Corte di Cassazione)*; nëse ka qënë *patteggiamento* është e mundur vetëm **kërkesa në Organin e Lartë të Drejtësisë**. Afatet për të prezantuar kundërshtimin mund të jenë 15, 30, 45 ditë, sipas rasteve:

- 15 ditë, kur arsyeja e vendimit është lexuar menjëherë me përfundimin e gjykimit;
- 30 ditë, kur arsyeja e vendimit është depozituar brenda 15 ditëve nga përfundimi i gjykimit;
- 45 ditë, kur arsyeja e vendimit është depozituar përtej ditës së pesëmbëdhjetë nga përfundimi i gjykimit.

> 3.4 Dërfitimet e burgut dhe masat e ndryshme të burgimit

(Mund të kërkoen vetëm kur dënimi bëhet përfundimtar).

> **Lirimi i parakohshëm (*liberazione anticipata* - është ulja e dënimit për sjellje të mirë)**

Çdo gjashtë muaj burgim, nëse keni:

- “marrë pjesë në veprën e riedukimit”,

mund të keni një ulje prej **45 ditësh** mbi dënimin, që ju mbetet për të bërë. Mund ta keni edhe për periudhat e kaluara në *paraburgim* (*custodia cautelare*) dhe kur jeni me *arrest shtëpie* (*arresti domiciliari*), por duhet ta kërkonit vetëm pasi dënimi të jetë bërë përfundimtar. Kërkesa e bërë me një formular përkatës (i cili ndodhet pranë seksionit) duhet t’i drejtohet *Gjykatës së Mbikqyrjes* (*Tribunale di Sorveglianza* - është gjykata, që merret me burgun dhe me të burgosurit). Dobia mund t’ju hiqet, në qoftë se kryeni krime të reja përpara se të keni mbaruar uljen e dënimit edhe në masë alternative.

Dënimi për një krim jo pa qëllim i bërë pas lëshimit të dobisë sjell shkarkimin. *Gjykata Kushtetuese* (*Corte Costituzionale*) **me vendimin nr. 186 të 23.05.1995 ka vendosur, që lirimi i parakohshëm** (*liberazione anticipata*) **mund të anulohet vetëm nëse sjellja e individit në raport me dënimin e pësuar, rezulton e papërputhshme me dobinë e dhënë.**

> Lejet e shpërblimit (*i permessi premio* - janë leje të disa ditëve për t’i kaluar në liri)

Mbi lejet **vendos** *Gjykatësi i Mbikqyrjes* (*Giudice di Sorveglianza*). Mund të keni maksimumi 45 ditë leje në vit (maksimumi 15 ditë radhazi). Për t’i patur këto leje është i rëndësishëm mendimi i favorshëm i Drejtorit dhe një raport i ekipit, që i parashikon në hipotezën trajtuese në përfundim të dokumentit të “*sintezës*” (*sintesi* - raport mbi sjelljen tuaj në burg). Gjithashtu, dënimi juaj duhet të jetë përfundimtar dhe duhet të keni bërë të paktën një të katërtën e dënimit, nëse i referohet krimeve jo të rënda. Ndërsa, nëse jeni i dënuar për vjedhje, rrëmbim, vrasje etj, mund të keni *permessi premio* vetëm pasi të keni bërë gjysmën e dënimit (por, megjithatë, jo më shumë se dhjetë vjet).

Për dënimin jo më tepër se tre vjet nuk është parashikuar një periudhë minimale dënimi për të marrë lejen e shpërblimit.

Nuk mund të jepen leje shpërblimi në rastet në vijim:

- për dy vjet, për ata që janë të pandehur apo të dënuar për një krim me qëllim të bërë ndërsa po bënin dënimin, domethënë, gjatë kohës në të cilën ishin nënshtruar ekzekutimit të një mase kufizuese të lirisë personale (për shembull. *arresti domiciliari*);

- për tre vjet, të dënuarve, që janë arratisur apo për ata që kanë pësuar anulimin e një mase alternative, pavarësisht nga natyra e krimit për të cilin është dhënë dënimi, që do shlyhet;

- për pesë vjet, të dënuarve për krime të rënda (vjedhje, rrëmbim, vrasje etj.) për të cilët të vazhdohet apo të shqiptohet dënimi për një krim të bërë me qëllim, të dënohet me burgim jo më të ulët në maksimumin e tre vjetëve, krim i bërë duke punuar jashtë (*lavoro esterno*), një *permesso premio*, një masë alternative ose gjatë një arratisje.

Si rrjedhim i modifikimeve të sjella nga i ashtuquajtimi ligj "ish-Cirielli", të dënuarve, të cilëve iu është aplikuar në vendim të dënimit "recidivi" sipas paragrafit të katërt të Nenit 99 të Kodit Penal, *lejet e shpërblimit (permessi premio)* mund t'ju jepen:

- a) pas shlyerjes të një së tretës së dënimit, për të dënuarit në arrestim ose në burgim më të ulët se tre vjet;
- b) pas shlyerjes të gjysmës së dënimit, për të dënuarit me burgim më të lartë se tre vjet, përveç sa është parashikuar në gjermën c;
- c) për të dënuarit për një nga krimet e parashikuara nga Neni 4 bis *Rendi i Burgut* ose për të dënuarit me burgim të përjetshëm, pas shlyerjes së dy të tretave të dënimit dhe megjithatë, jo më tepër se pesëmbëdhjetë vjet.

> Puna jashtë (*il lavoro esterno*) (Neni 21 O.P.)

Drejtori i Burgut mund t'ju japë mundësinë të kryeni një punë jashtë (nëse sjellja është e mirë dhe nëse personi është i besueshëm). Por, nëse jeni i dënuar për një krim të rëndë (vjedhje, rrëmbim, vrasje etj.) mund të punoni jashtë, vetëm pasi të keni shlyer një të tretën e dënimit (megjithatë jo më tepër se pesë vjet dhe dhjetë vjet për të dënuarit me burgim të përjetshëm). Puna jashtë mund t'iu lejohet edhe të pandehurve.

> **Gjysëm-liria** (*la semilibertà* - masë për të cilën qëndrohet në burg vetëm natën)

Sipas normës është mundësia për të dalë nga burgu gjatë ditës për të kryer një aktivitet pune, studimi apo vullnetariati, dhe në darkë të hyni sërish në burg. **Nevojitet të vështroni detyrat e programit** (orarin e daljes dhe të hyrjes, të mos largoheni nga vendet e treguara tek programi).

Për të patur *gjysëm-lirinë* (*semilibertà*) është e nevojshme të keni shlyer gjysmën e dënimit. Në rastet në të cilat mund të keni *vënien në provë tek shërbimet sociale* (*affidamento in prova ai servizi sociali*) (dënimi, që do shlyhet të jetë jo më i lartë se tre vjet) mund t'ju jepet *gjysëm-liria* (*semilibertà*), në qoftë se Gjykata mendon, që nuk janë kushtet për të dhënë birësimin: në këtë rast, nuk nevojitet të jetë shlyer gjysma e dënimit. Kjo mundësi nuk është e parashikuar për atë, që është dënuar për krime të rënda të veçanta (Neni 4 bis Rendi i Burgut: vjedhje e rëndë, rrëmbim i rëndë, trafikim të rëndë droge, vrasje etj).

Gjithashtu, për këto krime të rënda, *gjysëm-liria* (*semilibertà*) mund të merret vetëm, nqs është shlyer pjesa më e madhe e dënimit (të paktën dy të tretat). Edhe kush është dënuar me burgim të përgjeshëm mund të marrë *semilibertà*, por duhet të ketë shlyer të paktën njëzetë vjet të dënimit. (Për të llogaritur sa dënim keni shlyer, për të kërkuar *semilibertà*, shtoni edhe ditët, që keni patur për *lirinë e parakohshme*). Të dënuarit recidivë sipas Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal, mund të hyjnë tek *semi-libertà* vetëm pasi të kenë shlyer të paktën 2/3 e dënimit, por nëse bëhet fjalë për krime ish Neni 4bis Rendi i Burgut, vetëm pasi të keni shlyer të paktën • e dënimit.

Gjysëm-liria (*semilibertà*) nuk mund t'i jepet më shumë se një herë të burgosurit të cilit i është aplikuar recidivi i parashikuar nga Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal.

Mbani mend që, në lidhje me të gjitha masat alternative (*affidamento-vënia në provë, semilibertà-gjysëm-liria, detenzione domiciliare-burgimi shtëpiak*) **në qoftë se nuk respektoni rregullat**, masa mund t'ju ndërpritet nga *Magistrato di Sorveglianza* dhe ju do të ktheheni sërish (përkohësisht)

në burg. *Gjykata e Mbikqyrjes (Tribunale di Sorveglianza)* do të vendosë, nëq do t'jua anullojë apo jo masën brenda tridhjetë ditëve. Në rast anulimi, për tre vjet nuk mund të kërkonim më asnjë dobi, as *lejet e shpërblimit*.

> Vënia në provë tek shërbimet sociale (*affidamento ai servizi sociali*)

Mund të kërkonim birësimin, nëse ju mbetet të shlyeni një dënim të përfshirë brenda tre vjetëve.

Affidamento mund të kërkohet duke dërguar një kërkesë të posaçme *Gjykatësit të Mbikqyrjes*, i cili mund të pezullojë zbatimin e dënimit dhe t'ju zh'burgosë, duke pritur, që *Gjykata e Mbikqyrjes (Tribunale di Sorveglianza)* të marrë vendimin përfundimtar.

Pezullimi i dënimit mund të jepet në qoftë se Gjykatësi mendon, që ju keni mundësi të mira për të patur vënie në provë (*affidamento*), që të mos ketë rrezik arratisje dhe që vazhdimi i burgimit të mos krijojë një paragjykim të rëndë. *Gjykata e Mbikqyrjes (Tribunale di Sorveglianza)* duhet të vendosë brenda 45 ditëve duke filluar që nga dita, që i arrin kërkesa juaj, e përçuar nga Gjykatësi, por ky afat edhe mund të mos respektohet për shkak të punëve të shumta, që kanë Gjykatat.

Edhe pse formalisht nuk është e detyrueshme për dhënien e birësimin, por më vonë, në praktikë, puna është një element i domosdoshëm për të marrë birësimin në provë tek shërbimet sociale: kur bëni kërkesën është e përshtatshme, që të bashkëngjitni dokumentat në lidhje me ofertën e punës, përndryshe mundësitë për ta patur do të jenë të pakta. Gjithashtu, është absolutisht e domosdoshme, që kërkesa të jetë e pajisur nga shenja e vendbanimit, e rezidencës ose megjithatë të një sistemimi banues. Nuk është e mjaftueshme zgjedhja e vendbanimit pranë studios profesionale të avokatit.

Nëse kërkesa nuk pranohet, pezullimi i dënimit anulohet dhe ju duhet të ktheheni në burg, pa patur mundësinë, që ta bëni dhe njëherë kërkesën, as në lidhje me një masë tjetër alternative. Birësimi në provë tek shërbimet

sociale ju lejon të shlyeni dënimin në vendbanimin tuaj ose në një vend pritës, por duhet të respektoni **rregullat (prescrizioni)**, që vendosë Gjykata e Mbikqyrjes (*Tribunale di Sorveglianza*).

Rregullat më të shpeshta janë:

- të mos largoheni nga bashkia apo nga provinca juaj, nëse nuk jeni i autorizuar nga *Magistrato di Sorveglianza*;
- të mbani kontakte pesëmbëdhjetëditorshë me Asistentin social të UEPE (Zyra e Jashtme për Zbatimin Penal, ish qendra e Shërbimit Social për të Mëdhenjtë - C.S.S.A.);
- t'i dedikoheni një pune të qëndrueshme ose një aktiviteti vullnetar ose aktiviteteve shkollore ose të formimit profesional;
- të respektoni oraret kur të rrini pranë vendbanimit tuaj (zakonisht në orët e natës);
- mos të frekuentoheni me të dënuarit;
- të përdorenin në favor të viktimave të krimit.

Nëse jeni dënuar për krime të tipit mafioz, sekuestrim personi apo për trafik droge, mund të merrni birësimin vetëm nëse keni bashkëpunuar me drejtësinë.

Nëse jeni dënuar për vjedhje të rëndë, rrëmbim të rëndë, trafik droge të rëndë apo për vrasje, mund të merrni birësimin vetëm nëse nga informacionet e **komitetit provincial për rregullin dhe sigurinë publike (comitato provinciale per l'ordine e la sicurezza pubblica)** nuk rezultojnë elemente, që të çojnë në lidhje me krimin e organizuar. Mbani mend, që të keni një “*sintesi*” (domethënë, një raport të bërë nga operatorët mbi sjelljen tuaj në burg) të favorshme dhe të hyni në kufirin e dënimit të parashikuar me një dokumentacion, që të japë garanci mbi punën, që do të bëni kur të liroheni:

- një kërkesë punësimi e bërë nga një sipërmarrës pune mbi çdo dyshim

(domethënë jo i dënuar);

- ose regjistrimi në një shkollë, në një kurs profesional, në një aktivitet vullnetariati etj.

Birësimi në provë tek shërbimet sociale nuk mund t'i jepet më shumë se një herë të dënuarit të cilit i është aplikuar recidivi i parashikuar nga Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal.

➤ **Birësimi në provë në "raste të veçanta"** (për toksikomanët dhe alkolistët)

Nëse dënimi juaj apo mbetja e dënimit, që ju ka ngelur për ta shlyer është më e ulët se gjashtë vjet (katër, nëq flitet për të dënuarit, që kanë bërë një nga krimet e parashikuara nga Neni 4bis Rendi i Burgut) dhe ka ndërkohë një program rekuperimi nga toksikomania apo nëse ka ndërmend të marrë pjesë në këtë program, mund të kërkojë të birësohet tek shërbimet sociale për ta vazhduar apo ta rimarrë kur të dalë jashtë. Ky kufizim është shfuqizuar me dekret ligji, shfuqizim i konfirmuar më pas nga ligji i konvertimit 46/2006. Si rrjedhojë e modifikimeve të futura nga i ashtuquajtur i ligj ish-Cirielli, pezullimi i zbatimit të dënimit burgor dhe *affidamento in prova* në raste të veçanta në ballafaqim me një person toksikoman apo alkolist, të cilit i është aplikuar recidivi i parashikuar nga Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal, mund t'i jepen nëse dënimi burgor i dhënë apo, që duhet shlyer akoma mos t'i kalojë tre vjet.

Pezullimi i zbatimit të dënimit burgor dhe vënia në provë në raste të veçanta në ballafaqim me një person toksikoman apo alkolist, të cilit i është aplikuar recidivi i parashikuar nga Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal mund t'i jepen vetëm një herë.

Vënia në provë në "raste të veçanta" (*affidamento in prova in casi particolari*) nuk mund të jepet më shumë se dy herë. I burgosuri, që ka ndërmend të bëjë kërkesë birësimi kurues duhet të prezantojë kërkesë *Gjykatësit të Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)* duke bashkëngjitur patjetër çertifikatën e dhënë nga një strukturë sanitare publike ose nga një strukturë private, që i referohet toksikomanisë dhe programit kurues.

> Pranimi në masa të ndryshme për të dënuarit, që janë me Sidë ose me imunitet të pamjaftueshëm dhe shumë të rëndë (Neni 47 quater Rendi i Burgut, i futur nga ligji nr. 231/99)

Sipas normës së Nenit 47 quater Rendi i Burgut, të dënuarit e sëmurë me Sidë ose me imunitet të pamjaftueshëm shumë të rëndë, të cilët kanë ndërmend të ndërmarrin një program kure dhe asistence, mund të pranohen tek *vënia në provë (affidamento in prova)* ose *detenzione domiciliare*, si do që të jetë dënimi, që kanë për të shlyer.

Kërkesa duhet të jetë e pajisur me çertifikatë mjekësore e dhënë nga shërbimi sanitar publik kompetent ose nga shërbimi sanitar i burgut, që të vërtetojë kushtet e shëndetit dhe aktualitetin e programit të kurës dhe të asistencës pranë strukturave të spitalit ose të strukturave të tjera, që merren sipas planeve krahinore me asistencën e rasteve me Sidë. *Rregullat (prescrizioni)*, që rishikojnë masën alternative do të përmbajnë dhe ato, që i përkasin mënyrave të zbatimit të programit të kurës dhe të asistencës.

> Burgimi shtëpiak (*detenzione domiciliare* - domethënë të qëndroni detyrimisht në shtëpi pas gjyqeve)

Ka “raste” të ndryshme *detenzione domiciliare*: mund ta kërkonin kur **dënimi i mbetur** për të shlyer është përfshirë brenda **katër vjetëve** (afati është tre vjet, nëse bëhet fjalë për recidivë ish Neni 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal), nëse ndodheni në një nga **kushtet e mëposhtme**:

- jeni shtatzënë apo nënë me fëmijë, që kanë më pak se dhjetë vjeç dhe që jetojnë me ju;
- jeni baba me fëmijë, që kanë më pak se dhjetë vjeç dhe që jetojnë me ju, por vetëm nëse nëna ka vdekur ose nuk ka patur absolutisht mundësi për t’i mbajtur;
- jeni në kushte shëndeti shumë të rënda, të cilat ju bëjnë të keni kontakte të shpeshta me drejtorët sanitarë të territorit;

- keni më shumë se gjashtëdhjetë vjeç dhe jeni pjesërisht i paaftë;
- keni më pak se njëzetë e një vjeç dhe keni arsye shëndeti, studimi apo familjare.

Në qoftë se dënimi i mbetur për të shlyer nuk është më tepër se **dy vjet**, mund të keni *burgimin shtëpiak (detenzione domiciliare)* nëse:

- nuk janë kushtet për të dhënë birësimin në provë tek shërbimet sociale;
- gjykata mendon, që gjatë periudhës së *burgimit shtëpiak (detenzione domiciliare)* nuk do të bëni krime të tjera;
- krimi, për të cilin jeni dënuar nuk bën pjesë tek ata të përfshirë në Nenin 4bis Rendi i Burgut dhe që nuk janë deklaruar recidivë sipas Nenit 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal.

Si rrjedhojë e modifikimeve të sjella nga i ashtuquajtimi ligji “ish-Cirielli”, *burgimi shtëpiak* mund të jepet për çdo krim (përveç atyre krime, që kanë të bëjnë me skllavërinë, me dhunën seksuale dhe për krimet e parashikuara nga Neni 4bis Rendi i Burgut) mjaft, që të mos jetë deklaruar kriminel i zakonshëm, profesional apo për tendencë dhe të mos ketë qenë deklaruar kurrë recidivë sipas Nenit 99, paragrafi i katërt i Kodit Penal. Kërkesa duhet t’i drejtohet *Gjykatësit të Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)*.

Në këto dy hipoteza (dënimi jo më shumë se katër vjet në situatat e veçanta të shkuara më sipër dhe dënimi jo më tepër se dy vjet) *Magistrato di Sorveglianza* mund të aplikojë përkohësisht masën në pritje të vendimit të *Gjykatës së Mbikqyrjes (Tribunale di Sorveglianza)*.

Burgimi shtëpiak (detenzione domiciliare) mund të jepet edhe kur ju jeni në një nga kushtet, që shkaktojnë:

1) ndryshimin detyrues të dënimit (Gjykatësi është i detyruar të shtyjë zbatimin e dënimit)

- grua shtatzënë;
- nënë me fëmijë me moshë më të vogël se një vjeç;

- i sëmuri me Sidë ose me çfarëdolloj sëmundje të rëndë dhe të papërputhshme me gjendjen e burgimit.

2) ndryshimi fakoltativ i dënimit (Gjykatësi me takt mund të shtyjë dënimin)

- prezantimi i kërkesës së *faljes* (*grazia* - është fshirja e dënimit);
- person me sëmundje të rëndë fizike;
- nënë me fëmi me moshë më të vogël se tre vjeç.

Në këto raste, pavarësisht nga natyra e dënimit, që do shlyhet, *burgimi shtëpiak* (*detenzione domiciliare*) mund të jepet për një periudhë të caktuar dhe me shtytje të afatit. Kërkesa e “pezullimit të zbatimit të dënimit” duhet t’i drejtohet Gjykatësit të Mbikqyrjes. Mbani mend, që nqs largoheni nga vendi ku jeni me *burgim shtëpiak* (*detenzione domiciliare*, banim privat ose në një strukturë tjetër) kryeni krimin e arratisjes dhe kjo do të sjellë heqjen e dobisë.

> 3.5 Falja

Me ligjin 241 të datës 1.8.2006 hyri në fuqi Falja.

Me Faljen është ulur 3 vjet dënimi që duhet shlyer për krimet e bëra deri më 2.5.2006. Për shembull, nëse duhet të shlyeni 6 vjet dënim dhe keni shlyer 1 vit e 8 muaj të këtij dënimi, atëherë ju janë hequr 3 vjet të dënimit dhe ju mbeten kështu 1 vit e 4 muaj.

Disa krime janë përjashtuar nga Falja. Falja aplikohet automatikisht për atë që do të lirohet, në raste të tjera duhet të kërkohet.

4. Administrimi i raporteve juridike me institucionet

➤ 4.1 Analiza e rrezikshmërisë sociale dhe heqja e dëbimit

Me dënimin mund t'ju aplikohet masa e sigurisë (liria e kontrolluar, shtëpia e punës dhe nëse jeni qytetar jo-komunitar do të përjashtoheni nga territori i Shtetit), që do të zbatohet pasi të keni shlyer dënimin burgor. Në këtë rast, kur të jeni në përfundim të shlyerjes së dënitimit, *Cjkatësi i Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)* do të caktojë seancën për të verifikuar nëse jeni akoma i rrezikshëm për shoqërinë dhe nëse duhet të vazhdojë apo jo në zbatimin e masës së sigurisë.

Nëse keni përfunduar pozitivisht një masë alternative, *Magistrato di Sorveglianza* mund të vlerësojë në favorin tuaj pushimin e rrezikshmërisë sociale.

Keni të drejtë të qëndroni në Itali deri në ditën e seancës për verifikimin dhe për këtë qëllim mund të kërkonti një leje qëndrimi të përkohshme “për arsye drejtësie”, me qëllim, që të jeni i pranishëm në seancën, që ju takon; nqs, seanca nuk do të ketë rezultatin e dëshiruar, atëherë përjashtimi bëhet përfundimtar. Në çdo rast, nëse në vendin tuaj të ardhjes rrezikoni të pësoni përndjekje për arsye racismi, politike, fetare, seksi, gjuhe, nënshtetësie etj, nuk mund të përjashtoheni; në të njëjtën mënyrë nuk mund të përjashtohen të miturit, gratë shtatzane dhe ato që sapo kanë lindur; të huajt e martuar me italianë ose ata që bashkëjetojnë me farefis (deri të gradës së katërt) me kombësi italiane (Neni 19 Testo Unico mbi kushtet e të huajit).

Nëse janë këto situata, është e përshtatshme, që ta bëni të pranishme që në fillim duke i shkruajtur Kuesturës.

Gjithashtu, mbani mend, që dëbimi mund të vendoset dhe në rrethana

të tjera:

- si sanksion alternativ në këtë rast, detyra i takon *Gjykatësit të Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)*, që ka jurisdiksionin mbi Institutin në të cilin ju ndodheni) atëherë kur dënimi, që mbetet për të shlyer mos të jetë më i lartë se dy vjet; ose si sanksion zëvendësues nga i njëjti gjykatës, që ka vënë vendimin e dënimit, kur mendon të japë një dënim burgor brenda afatit të dy vjetëve dhe kur nuk janë kushtet për aplikimin e pezullimit me kusht të dënimit;
- si sanksion administrativ për shkelje të ligjeve mbi emigracionin;
- si rrjedhojë e dënimeve për krime kundër personalitetit të Shtetit (krime terrorizmi etj.).

➤ 4.2 Rinovimi i lejes së qëndrimit

Nëse **zotëroni një leje qëndrimi për arsye pune** në skadim, mund të bëni kërkesë rinovimi nga burgu, por kini parasysh në çdo rast, që dënimi për një “krim ndalues” (të gjitha krimet për të cilat është parashikuar arrestimi detyrues në flagrancë) pengon rinovimin e lejes së qëndrimit.

Nëse arrini të merrni masën alternative pasi të keni nënshkruar një kontratë pune të rregullt, mund të prezantoni kërkesë për rinovimin e lejes duke paraqitur si motiv vonese për shkaqe të forcës madhore.

Nëse keni një leje qëndrimi për arsye familjare ju leverdis të kontaktoni vullnetarët e Shoqatës Altro Diritto për të patur një konsulencë.

➤ 4.3 Rregullat e burgjeve evropiane (Ndërhyrje e

Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës 12.2 87)

Të gjitha rregullat e burgut duhet të aplikohen paanësisht. Nuk duhet të ketë asnjë lloj diskriminimi race, seksi, gjuhe, feje, opinione politike

ekonomike. Besimet fetare dhe parimet morale të grupit në të cilin bëni pjesë duhet të respektohen. Në momentin e hyrjes në Institut, keni të drejtë të merrni informacione rreth jetës së burgut, rreth kontakteve me autoritetet gjyqësore dhe rreth të gjitha atyre gjërave, që janë të nevojshme për të njohur të drejtat dhe detyrat tuaja.

Keni të drejtë t'i komunikoni Ambasadës (ose Konsullatës) së vendit tuaj, që ndodheni në gjendje burgimi.

Keni të drejtë të keni një përkthyes për raportet, që do të keni me gjykatësit dhe me zurat publike. Nëse gjyqi është në vazhdim, të gjitha aktet, që ju njoftohen duhet të përkthehen në gjuhën tuaj. Mbani me kujdes të gjitha aktet juridike, që ju dorëzohen nga *Ufficio Matricola* ose nga *Nëpunësi Gjyqësor (Ufficiale Giudiziario* - është personi, që asiston Gjykatësin gjatë seancës: mund t'ju shërbejnë për të dokumentuar lutje, kërkesa etj).

Duhet të jeni i autorizuar të kënaqni nevojat e jetës suaj fetare dhe shpirtërore. Nëse në Institut ndodhet një numër i mjaftueshëm të burgosurish, që praktikojnë të njëjtën fe, një përfaqësues i kualifikuar i kësaj feje duhet të rinjohet ose të emërohet: ai mund të organizojë shërbimet dhe aktivitetet fetare dhe t'i bëjë vizita të burgosurve.

> 4.4 Transferimi jashtë Shtetit të personave të dënuar

> Si të kërkonte transferimin?

Është e mundur të kërkonte transferimin në Vendin prej të cilit vini, për ta shlyer atje dënimin e pësuar në Itali.

Me këtë qëllim duhet t'i bëni një kërkesë Ministrisë së Drejtësisë të Italisë ose Ministrisë së Drejtësisë të Shtetit të Vendit nga i cili vini.

Transferimi do të jetë i mundur nëse janë këto kushte:

- që ju të jeni qytetar i Shtetit në të cilin kërkonti transferimin;
- që dënimi të jetë përfundimtar;
- që ju duhet të shlyeni një dënim më të lartë se gjashtë muaj (në momentin e marrjes së kërkesës nga ana e Ministrisë);
- që fakti për të cilin ju jeni dënuar të përbëjë një krim edhe për ligjin e Shtetit në të cilin ju kërkonti të transferoheni;
- që midis Italisë dhe Vendit në të cilin kërkonti, që të transferoheni, të ketë një marrëveshje internacionale përkatëse, që të parashikojë këtë mundësi.

> Çfarë ndodh pas transferimit?

Dënimi i pësuar në Itali do të konvertohet në një dënim të parashikuar nga kodi penal i Shtetit të vendarritjes për të njëjtin tip krimi. Megjithatë, pozicioni juaj penal nuk mund të keqësohet nga konvertimi (dënimi juaj nuk do të shtohet). Periudha e kaluar në burgjet italiane do të zbritet kompletësisht nga dënimi, që do t'ju caktohet.

Mund të keni amnisti të mundshme ose masa *falseje* si nga Shteti italian ashtu dhe nga Vendi ku keni kërkuar të transferoheni. Rishikimi i mundshëm i gjyqit do të mbetet detyrë vetëm e Shtetit italian.

> 4.5 Ekstradimi (*estradizione* - është dorëzimi i i një personi nga

një Shtet në tjetrin, në të cilin është dënuar për një krim)

Ekstradimi juaj në një Shtet tjetër mund të jepet vetëm kur fakt-objekti i kërkesës së ekstradimit është parashikuar si krim si nga ligji italian ashtu dhe nga ai i Shtetit kërkues.

Ekstradimi, megjithatë, nuk mund të jepet në rastet në vazhdim:

- në raport me krimet politike (përfshihet gjenocidi);

- kur ligji i Shtetit kërkues parashikon dënimin me vdekje për krimin objekt të kërkesës (përveç se kur Shteti kërkues nuk jep garanci mbi faktin, që dënimi nuk do të kryhet);
- kur i interesuari i kërkesës së ekstradimit është dënuar me vdekje në Shtetin kërkues ose rrezikon një dënim të ngjashëm për fakte, që nuk janë të treguara në kërkesën e ekstradimit.

5. Administrimi i raporteve ekonomike me institucionet

➤ 5.1 Gjoha dhe riparimi material apo moral i një dëmi*(a multa e lammenda)*

Dënimet e burgut mund të quhen “gjoha” ose “riparimi material apo moral i një dëmi”. Ato vendosen në mbarim të një gjyqi dhe mund të shoqërojnë dënimin në burgim ose të përbëjnë të vetmin sanksion, që mund të jepet. Shumë krime parashikojnë si dënimin e burgut ashtu dhe atë përsa i përket parasë. Për shembull, për krimet e drogës dhe të kontrabandës parashikohen gjoha shumë të repta.

Dënimeve të parave (gjoha ose riparimi material apo moral i dëmit), që jepen nga Gjykatësi i meritës me një seancë dënimi, i shtohet, në rastin kur është bërë kërkesa për Kushtetutën e deklaruar e papranueshme, shuma nga ana e Gjykatës të një sanksioni burgor përfshihet midis 258,00 dhe 2.065,00 euro. Nuk bëhet fjalë, në krahasim me gjobën dhe me riparimin material apo moral të dëmit, të një sanksioni penal, por administrativ, që konkretizohet në detyrimin e derdhjes së shumës së caktuar nga Gjykata në *Kasën e Riparimeve materiale apo morale (Cassa delle Ammende)*.

Kur nuk keni kushtet ekonomike për të paguar, gjoha dhe riparimi material apo moral i dëmit konvertohen në një dënim zëvendësues, që qëndron në lirinë e kontrolluar.

Informacioni midis dënimin në para dhe lirisë së kontrolluar bëhet duke llogaritur 38,73 euro të dënimin në para për një ditë lirie të kontrolluar. Zgjatja totale e *lirisë së kontrolluar (libertà controllata)* nuk mund të kalojë megjithatë:

- një vit e gjashtë muaj, nëse bëhet fjalë për një gjobë;
- nëntë muaj, nëse bëhet fjalë për një riparim material apo moral të

dëmit.

Lirinë e kontrolluar (libertà controllata) duhet ta shlyeni në fund të burgimit, e cila sjell disa detyrime dhe ndalesa, që vendosen nga *Gjykatësi i Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)*: të paraqiteni çdo ditë në kazermë, mos të dilni nga komuna e banimit etj. (Ekziston mundësia të ndaloni në çdo moment dënimin zëvendësues duke paguar gjobën ose riparimin material të duhur).

Nëse nuk respektohen të gjitha *parashkrimet e lirisë së kontrolluar* ose të punës, që është shoqërisht e dobishme, të cilat vendosen nga gjykatësi, ditët që mbeten nga dënimi i zëvendësuar do të shlyhen në burg.

Zëvendësimi i dënimit në para me *lirinë e kontrolluar (libertà controllata)* ose puna e dobishme detyron të huajtë edhe pse janë të dënuar me përjashtim në seancë, të qëndrojnë në Itali deri në mbarimin e dënimit zëvendësues.

Nëse keni synim të paguani, në vend, që të shlyeni dënimin zëvendësues, por për momentin nuk keni para të mjaftueshme, mund të kërkonti, që ta paguani me këste atë që ju takon, duke i bërë një kërkesë të posaçme *Gjykatësit të Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)*. Çdo kësht, megjithatë, nuk mund të jetë më i ulët se 15,00 euro dhe këstet mund të jenë të shumtën tridhjetë. Mund të kërkonti të shtyni pagesën për gjashtë muaj, nëse parashikoni të keni në atë moment lekët për të paguar shumën, që ju takon.

Duke nënvizuar, që rezultati pozitiv i besimit (është i tillë kur keni masën deklaruese të *Gjykatës së Mbikqyrjes - Tribunale di Sorveglianza*) shlyen dënimin e parasë, nëse i besuari ndodhet në kushte ekonomike të varfra (rrethanë, që i interesuari ka barrën, që ta bashkëngjisë dhe ta tregojë).

Shënim: Për këto dënime në para (gjoba dhe riparimi material apo moral i dëmit) nuk është e mundur të kërkoksh në asnjë rast, faljen e borxhit.

➤ 5.2 Harxhimet gjyqësore dhe të mbajtjes në burg

Nëse jeni në përfundim të burgut, do t'ju kërkohet pagesa e harxhimeve të gjyqit dhe paratë, që i takojnë avokatit të zyrës (nëse nuk bënit pjesë tek mbrojtja falas).

Do t'ju kërkohet dhe pagesa e një kuote të përditshme për mbajtjen në burg, aktualisht e caktuar në shumën e 1,80 euro. Kjo shumë përfshin çmimin e ushqimeve dhe atë të përdorimit të pajisjeve personale të furnizuara nga administrata e burgut (dyshek, çarçaf, pjata, lugë etj.).

Për mbulimin e këtyre dy shpenzimeve i përgjigjeni me të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që zotëroni (përveç një pjese të rrogës së punës edhe pse keni punuar në burg dhe të pensionit, që nuk mund të merren).

Nëse keni vështirësi ekonomike, mund të kërkoni, që shpenzimet gjyqësore dhe të mbajtjes t'ju dërgohen, domethënë t'ju falen. (Përveç faktit, që ndodheni në vështirësi ekonomike, është e nevojshme, që të keni patur dhe një sjellje të mirë gjatë burgimit).

Nëse kërkesa pranohet, nuk do të paguani më këto shpenzime. Në këtë rast, do t'ju merren vetëm harxhimet e mbajtjes gjatë muajve të burgimit, që keni punuar.

Për të kërkuar faljen e borxhit duhet të paraqesni një kërkesë të posaçme *Gjykatësit të Mbikqyrjes (Magistrato di Sorveglianza)*. Kërkesa e faljes së borxhit duhet të bëhet menjëherë sapo të keni marrë lajmërimin e pagesës, e cila sjell një pezullim të përkohshëm të procedurës për marrjen e shumave, që i detyroheni. Kur të përfundojë dënimi, *Magistrato di Sorveglianza* do të vlerësojë nëse ndodheni në kushtet për të patur faljen e borxhit.

Paga për punën e bërë në burg ndahet midis fondit të gatshëm (4/5) dhe fondit të detyruar (1/5). Paratë e fondit të detyruar do t'ju jepen kur të mbarojë dënimi, por në qoftë se nuk ia dilni dot, mund të kërkoni me

një formular të posaçëm, që do ta gjeni në repart duke cilësuar arsyet e kërkesës suaj (nuk është e thënë, që kërkesa të pranohet gjithëmonë).

> 5.3 Dëmshpërblimi

Kur krimi për të cilin jeni dënuar ka shkaktuar dëme personave të tjerë dhe këta kanë ardhur në gjyq për tu mbrojtur, duhet t'i shpërbleni dëmin. Shuma për dëmshpërblimin e caktuar nga gjykatësi, mund të rekuperohet me shitjen e pasurive, që zotëroni ose duke jua mbajtur tek rroga deri në një maksimum prej 2/5 (duke përfshirë shpenzimet e mbajtjes). Ashtu si dënimet e parave dhe këto shuma, që i takojnë dëmshpërblimit, nuk mund të falen.

Shënim: Pagesa e gjobave, e harxhimeve gjyqësore dhe të mbajtjes, dhe dëmshpërblime të mëtejshme (për kë ka kushtet ekonomike për ta bërë) përbën një cilësi të nevojshme për të patur *lirimin me kusht (liberazione condizionale)*, *faljen (grazia)* dhe *riabilitimin (riabilitazione - është heqja e çdo dënimi dhe pastrimi i çdo çertifikate penale)*.

6. Sporteli i dokumentave dhe Kujdesi i tyre *(Sportello Documenti e Tutele)*

> 6.1 Dobitë në mbështetje të të ardhurave dhe dokumenta të tjera

Është aktiv brenda burgut Sollicciano një shërbim i quajtur “Sporteli i Dokumentave dhe Kujdesjet”, funksioni i të cilit është ai, që të garantojë hyrjen e disa masave për mbështetjen e të ardhurave (si kompensimin e papunësisë ose çeqet familjare) ose për të marrë disa dokumenta (si kodin fiskal ose kartën e identitetit).

Për të hyrë tek shërbimet e sportelit, në disa raste mund të kërkonti një takim direkt me operatorët, në raste të tjera mund ta bëni me anë të *shkruesit (scrivano)* të repartit tuaj.

Takim i drejtëpërdrejtë me operatorët për: regjistrimin në zyrë, rinjohjen e invaliditetit civil, kërkesë për pensionin e invaliditetit, kartën e identitetit.

Përmes shkruesit: kompensimi i papunësisë dhe çeqet familjare.

Në vazhdim do të gjeni të dhënat për përdorimin e të gjitha shërbimeve.

> 6.2 Vendbanimi civil

Mund ta kërkojnë të burgosurit, që janë dënuar me gradën e parë. Në praktikë, i dërgohet kërkesa e shënimit të vendbanimit pranë NCP Sollicciano për të burgosurit përfundimtarë, që kanë një dënim të mbetur më të lartë se dy vjet. Të dënuarit, që duan të kërkojnë vendbanimin civil në Sollicciano mund t’i drejtohen operatorit të Sportelit, që do të verifikojë pranë zyrave kompetente mundësinë për ta patur.

> 6.3 Dokument të identitetit personal dhe të tjera çertifikata të gjendjes civile

Nëse keni nevojë për Kartën e Identitetit, bëni kërkesë tek Sporteli duke patur parasysh, që Kartën mund ta merrni vetëm nëse keni banimin në Itali.

Do t'ju kërkohet dhe një fotokopje e Kartës së Identitetit të skaduar.

> 6.4 Kompensim papunësie me cilësi të reduktuara (*Indennità di disoccupazione con requisiti ridotti*)

Çfarë është?

Është një masë në mbështetje të të ardhurave, që i takon të burgosurve, që kanë punuar gjatë vitit para kërkesës.

Cilat janë cilësitë?

Cilësitë për vitin për të kërkuar kompensimin e papunësisë janë:

- 1) të keni punuar në vitin e kaluar para kërkesës, të paktën 78 ditë (vini re: dhe një orë e punuar në një ditë vlen sa për një ditë pune);
- 2) të keni derdhur kontribute para dy vjetëve, para se të kërkonit kompensimin (per shembull, nëse kërkesa bëhet në 2006 duhet të keni punuar të paktën një javë para datës 31/12/2004).

Kompensimi paguhet për një periudhë, që i korispondon ditëve, që keni punuar gjatë vitit.

Kur ta kërkonti?

Kërkesa bëhet midis 1 janarit dhe 31 marsit të çdo viti.

Si dhe kujt t'ia kërkonti?

Operatorët e Sportelit të Dokumentave dhe Kujdesjet midis shkurtit dhe

marsit të çdo viti, aktivizohen për dhënien e shërbimit.

Për të përdorur shërbimin:

- regjistrohuni tek lista e parapregatitur nga *scrivano* i repartit tuaj;
- prisni, që operatorët të verifikojnë përmes Zyrës së Llogarive Bankare (*Ufficio Conti Correnti* - është zyra që merret me paratë e të burgosurve) të burgut ose nëpërmjet l'INPS (INPS - Instituti Nacional i Sigurimeve Shoqërore) vlefshmërinë e cilësive;
- nëse verifikimet do të japin rezultat pozitiv, do të plotësohet nga *scrivano* kërkesa e posaçme, që operatorët të kujdesen për t'ia dërguar INPS;
- në rastin në të cilin, në vitin e kaluar para se të bënit kërkesën, keni punuar jashtë burgut, duhet t'i kërkonte ish punëdhënësit tuaj plotësimin e një formulari të posaçëm (DL86/88).
- Në rast alternativ, mund të zgjidhni të mos përdorni shërbimin e ofruar nga Sporteli duke plotësuar kërkesën për kompensimin dhe t'ia dërgoni direkt INPS.

> 6.5 Çeqet familjare

(Assegni familiari)

Çfarë janë?

Janë një instrument në mbështetje të të ardhurave të familjeve. Iu takon të gjithëve punëtorëve të varur, të papunëve, punëtorëve në lëvizje, ortakëve të kooperativave, të pensionuarve. E drejta për të kërkuar çeqet familjare është parashikuar nga *Rendi i Burgut*, që Neni 23 reciton: "Të burgosurve dhe të internuarve, që punojnë duhet t'i jepen, për personat, që kanë në ngarkim, çeqet familjare në masën dhe sipas mënyrave të ligjit". Çeqet familjare i jepen direkt personave, që janë në ngarkim sipas mënyrave të caktuara nga rregullorja 2.

Kur t'i kërkonte?

Mund t'i kërkonte çeqet familjare në qershor dhe në korrik të çdo viti. Mund të kërkonte gjithashtu, të prapambeturat e 5 viteve të mëparshme. Mund t'i kërkonte nëse punoni në burg ose për periudhën, që keni punuar në burg.

Për cilët familjarë mund të kërkohen?

- çeku i kërkuesit;
- bashkëshorti jo ligjërisht i ndarë;
- fëmijët (e ligjshëm, jo të ligjshëm, adoptivë, e birësuar, natyralë, e njohur ligjërisht ose të deklaruar me gjyq, e lindur nga martesë e mëparshme e bashkëshortit tjetër, e besuar sipas normës së ligjit) dhe nipërit, që jetojnë në ngarkim të paraardhësit direkt me moshë më të vogël se 18 vjeç;
- fëmijët madhorë të paaftë, që ndodhen, për defekt fizik apo mental, në pamundësinë absolute dhe të përhershme për t'iu dedikuar një pune me dobi;
- vëllezërit, motrat dhe nipërit kolateralë të kërkuesit minorë në moshë ose madhorë të paaftë, me kusht, që të jenë jetimë nga të dy prindërit dhe të mos kenë të drejtën e pensionit të shpëtuarve.

Mund të kërkojnë çeqet familjare dhe të burgosurit e huaj për bashkëshorten dhe fëmijët, që qëndrojnë rregullisht në Itali. Nëse familjarët ndodhen në vendin e origjinës, nuk mund të kërkohen çeqet familjare, me përjashtim të qytetarëve të Kapoverdes, Kroacisë, Jersey, Ishujt e Kanalit, Principatit e Monakos, Sllovenisë, Tunizisë dhe të ish Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë.

Cila dokumenta nevojiten?

- gjendja e familjes ose autoçertifikimi i gjendjes familjare mbi një formular të dhënë nga INPS;
- deklaratë e vërtetuar e bashkëshortit në të cilën deklaron, që nuk ka të ardhura (ose, nëse ka, duhet të tregojë sa ka) ose në alternativë, certifikimin ISEE të marrë nga CAF;
- bashkëshorti duhet të nënshkruajë edhe formularin e kërkesës së çeqeve familjare, në alternativë, mund të shtoni në deklaratën e vërtetuar duke shkruajtur “deklaroj që nuk marrë dhe nuk kam kërkuar çeqet familjare”;
- duhet gjithashtu, të njihni kodet fiskale të familjarëve, që keni në ngarkim për t'i regjistruar tek formulari (nuk është e nevojshme fotokopja e kodeve fiskale, por është e mjaftueshme t'i tejkshkruani tek formulari).

Si dhe kujt t'ia rikërkoni?

Mund t'ia kërkoni formularin shkruesit. Pasi ta keni plotësuar formularin, dërgojeni duke bashkëngjitur gjendjen familjare dhe deklaratën e

bashkëshortit, tek Ufficio Conti Correnti.

Në rastin në të cilin formulari rezulton i paplotësuar ose i plotësuar gabimisht, do të kontaktoheni menjëherë nga Operatorët e Sportelit.

Nëse hasni probleme gjatë plotësimit të formularit mund të kërkonti ndihmën e Operatorëve të Sportelit duke paraqitur një *kërkesë drejtuar "Sportelit të Dokumentave dhe Kujdesjet"* në të cilën duhet të tregoni:

- emrin dhe mbiemrin tuaj;
- repartin dhe qelinë;
- arsyen e kërkesës (për shembull: plotësimi i formularit të çeqeve familjare).

> 6.6 Regjistrimi në zyrën e punës së zakonshme dhe në atë për invalidët (*Iscrizione al collocamento ordinario e per disabili*)

Mund të regjistrohen në listën e invalidëve të gjithë të burgosurit, që banojnë rregullisht në territorin italian dhe që gjenden në kushtet në vijim:

1. personat me mangësi fizike, psiqike dhe të vonuarit, që kanë një përqindje invaliditeti të barabartë ose më të lartë se 46%;
2. të paaftit në punë me përqindje invaliditeti të barabartë ose më të lartë se 34%;
3. të verbërit dhe shurdhmemecët (L. 382/70 dhe L. 381/70);
4. invalidët e luftës, invalidët civilë të luftës dhe invalidët për shërbim.

Për tu regjistruar në listën speciale është e nevojshme të keni rinjohjen formale të invaliditetit, e cila jepet pas vizitës së Komisionit lokal të ASL (ASL - Qendra Sanitare Lokale).

Mund të regjistrohen në listën e zakonshme të gjithë të burgosurit, që

banojnë rregullisht në territorin italian. Kush është regjistruar përpara se të hynte në burg, duhet të ruajë regjistrimin. Regjistrimi nuk sjell asnjë lloj vantazhi (si për shembull furnizimi i ndihmave ose dëme fiskale).

Si të kërkonti rinjohjen e invaliditetit dhe/ose si të bëni regjistrimin në listë?

Kërkonti një takim me operatorët e Sportelit duke i paraqitur një kërkesë të drejtuar “Sportelit të Dokumentave dhe Kujdesjet) në të cilën tregoni:

- emrin dhe mbiemrin tuaj;
- repartin dhe qelinë;
- arsyen e kërkesës (tregoni nëse bëhet fjalë për: regjistrim në listë të zakonshme apo invalidësh, ose nëse doni të kërkonti rinjohjen e invaliditetit civil).

> 6.7 Pensionet e vjetërsisë, invaliditeti dhe shoqërorët (*Pensioni di anzianità, invalidità e sociale*)

- Pensioni i vjetërsisë. I takon atij, që ka mbushur vitet e vjetërsisë me kontributet e parashikuara nga ligji, të cilat janë të ndryshme sipas kategorisë së punës, që i përkasin.
- Pensioni i invaliditetit. I takon invalidëve të regjistruar në listën e të paafteve.
- Pensioni shoqëror. I takon të dënuarve italianë, të komunitetit evropian ose të huajve me kartë qëndrimi, që janë 65 vjeç, që banojnë në Itali dhe nuk kanë të ardhura.
Për të marrë pensionin duhet të bëni kërkesë te Sporteli me mënyrat e treguara mësipër duke cilësuar llojin e pensionit për të cilin bëni kërkesën.

7. Rrjeti qytetar i shërbimeve Zona e zbatimit penal brenda dhe jashtë burgut

Kjo është një listë e Shoqatave, që merren me burgun dhe me masat alternative në zonën fiorentine.

➤ **Altro Diritto** (Shoqata)

• *Sportel i brendshëm në Sollicciano për dokumenta si: çeqet familjare, kompensimet, papunësia, regjistrimi në listë, pensioni i invaliditetit, pensioni shoqëror, pensioni i vjetërsisë.*

• *Aktivitet i brendshëm dhe i jashtëm i këshillave gjyqësore.*

PËR KONTAKTE:

Domandina brenda "Sportelit të Dokumentave dhe Kujdesjet" - Shoqata Altro Diritto;

Kontakte të jashtme c/o Qendra Attavante - tel. 055.7364043 (15.00-21.00)

Oppure UEPE: tel. 055.263191 - attavante@hotmail.it - adir@altrodiritto.unifi.it

Aktivitete të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ **Arci - Comitato Territoriale di Firenze** (Shoqata e Nismës Sociale)

• *Gjallëri e brendshme - Kurs pikturë dhe Muzikë.*

• *Shoqata "Zh'burgosemi" për aktivitetet sportive. (Nicola Zuppa, Marco Lombardo). Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Arci - Comitato Territoriale di Firenze tel. 055.262971

Francesca Chiavacci, Marco Lombardo, G. Parissi - tel. 055.26297245

Piazza de Ciompi, 11 - parissi@arci.it

Aktivitete të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ **AISME** (Shoqata)

• *Mbështetje psikologjike për personat me probleme shëndeti mental edhe me probleme penale. Ta përdorni në dalje.*

PËR KONTAKTE:

duhet t'i shkruani Zonjës Donatella Miccinesi - Via Forlanini 164 c/o Casa della Cultura - Firenze - centrosh@tiscali.it

Aktivitete të jashtme

➤ **Alcolisti Anonimi**

- *Ndihmë - ndihmë për tu shëruar nga alkolizmi, për personat e lirë ose në masë alternative. Ta përdorni në dalje.*

PËR KONTAKTE:

Eugenio Lumini - "Gruppo Rucellai" Piazza S. Salvi, 4 - tel. 055.671296
indiano38@aliceposta.it

Aktivitete të jashtme

➤ **Arci - Scarcerarci** (Shoqata)

- *Aktivitete sportive, mbrojtja civile, mbledhja e fondeve. Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Nicola Zuppa, Marco Lombardo - tel. 055.26297230
- Piazza de Ciompi, 11 - scarcerarci@libero.it

Aktivitete të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ **Aria** (Shoqata Teatralmuzik-ore)

- *Kurs teatri për femrat. Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Patrizia De Libero - p.delibero@virgilio.it - Kontakte: Zyra e Edukatorëve

Aktivitete të brendshme

➤ **Associazione Volontariato Penitenziario** (Shoqata Onlus)

- *Mbështetje e brendshme-e jashtme e masave alternative me strukturë pritje ditore. Attavante.*
- *Administrimi i Projektit Giobbe për shpërndarjen e rrobave dhe të produkteve të higjienës. Plotësoni kërkesën (domandina) e posaçme.*

PËR KONTAKTE:

Carla Cappelli, Nadia Monticelli, Maria Milani, Dimitri Sani.
tel. 055.486140 (sekretaria telefonike dhe fax) - attavante@hotmail.it
Sede: Via Cavour 57, pranë il Tribunale di Sorveglianza.
Qendra Attavante tel. 055.7364043 (15.00-21.00)

Aktivitete të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ **CARITAS** (Associazione Onlus) - **CENTRO ACCOGLIENZA "IL SAMARITANO"**

- *Pritja pranë qendrës "Il Samaritano" për të dënuarit me leje, personat në masa alternative, ish-të dënuarit.*

PËR KONTAKTE:

shkruani në: Caritas, Samaritano Via Baracca, 150/e - Firenze
Lisa Vannini. Via F. Baracca, 150/e - Firenze - tel. 055.3438680; ose:
Caritas, Via de' Pucci 2 - tel. 055.267701 - accoglienza@caritasfirenze.it
Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Teatro degli Stregatti (Shoqata)

• *Aktivitet teatral me të burgosurit e burgut Sollicciano - seksioni i meshkujve. Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Elisa Taddei Zyra e Edukatorëve Sollicciano tel. 055.73721

Aktivite të brendshme

➤ CIAO "Centro Servizi" (Shoqata Onlus)

➤ QENDRA E PRITJES "CASANOVA"

• *Mbështetje, informacione dhe shoqërimi të masave alternative dhe të punës.*

PËR KONTAKTE:

shkruani tek Shoqata Ciao Via S. Zanobi, 104/r - Firenze

L. Tusacciu, E. Cecchi, M. Bartalucci, E. Baldini, Stefano Barbieri, A. Pea, P. del Sere.

tel. 055.4630876 / 055.4633523 - cc.centroservizi@email.it

9.30-13.00 nga e hëna deri të premtën mbasdite, vetëm duke marrë takim

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Suore Vincenziane S. Caterina - Qendra e pritjes femërore S. Maria

• *Pritja për gra në permesso premio ose në masa alternative.*

PËR KONTAKTE: *Domandina* e brendshme

Suor Rosa, tel. 055.495341/ 055.472053

Via S. Caterina d'Alessandria, 15 - Firenze - s.caterina.fi@libero.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ CAT Cooperativa Sociale Onlus

• *Përkthime gjuhësore-kulturore pranë burgut Sollicciano.*

PËR KONTAKTE: Zyra e Edukatorëve.

Viale Guidoni, 26 - Firenze - tel. 055.422390 - interpretariato@copcat.it

Aktivite të brendshme

➤ OASI - QENDRA E PRITJES Padri Mercedari

- *Pritja për të burgosurit në leje, persona në masa alternative, ish të burgosur.*

PËR KONTAKTE:

shkruani në OASI Via Accursio, 19 Firenze

Padre Antonio Pinna, Patrizia Marinai, Lucia Niccolai - Qendra Padri Mercedari, Via Accursio, 19 - Firenze - tel. 055.2049112

oasi@oasifirenze.it - www.oasifirenze.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Fondazione Michelucci

- *Studime dhe kërkime mbi burgun dhe mbi raportin midis burgut dhe shoqërisë.*

PËR KONTAKTE:

Fondazioni Giovanni Michelucci - Via Beato Angelico, 15 - 50014 - Fiesole - Firenze - Italy

Nicola Solimano, Mara Ceccatelli, Alessio Scandurra.

tel. + 39.055.597149 - Fax + 39.055.59268

fondazione.michelucci@michelucci.it - www.michelucci.it

Aktivite të jashtme

➤ Cooperativa Sociale Ulisse

- *Aktivitet pune brenda dhe jashtë burgut: ofiçina brenda institutit penal në Sollicciano, ofiçina jashtë burgut për të rregulluar biçikletat e ardhura nga depozita komunale. Biçikleta me qera në qytet. Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Gianni Autorino Via Galeotti, 7 - Firenze - tel. 055.6505295

presidenza@cooperativaulisse.org

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Il Giardino dei Ciliegi (Shoqata)

- *Kurs shkrimi kreativ: të mësoni të tregoni histori. Kursi i drejtohet studentëve të shkollës së mesme të Mbikqyrjes së Lartë. Kontakte: Zyra e Edukatorëve.*

PËR KONTAKTE:

Mara Baronti Via dell'Agnolo, 5 - tel. 055.2001063

ilgiardinodeiciliegi1@virgilio.it

Aktivite të brendshme

➤ Il Muretto

- *Mbështetje për të burgosurit përmes bisedimeve dhe udhës së futjes.*

PËR KONTAKTE:

i shkruani Don Alessandro Santoro Via Lombardia 1/p Le Piagge - Firenze
- tel. 055.373737 - ilmuretto@libero.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Il Varco (Shoqata)

- *Riedukim për futjen, shoqërimin, mbështetjen përmes shoqatave të tjera për punën.*

PËR KONTAKTE: *Domandina diretta*

Giuseppe Mancini c/o Centro Attavante, 2 - tel. 055.7364043
info@ilvarco.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Leonardo Onlus (Shoqata)

- *Vizita të përditshme të burgosurve dhe ndihma në futjen e punës.*

PËR KONTAKTE: *Domandina diretta*

Quirino Caselli - Leonardo onlus c/o Cavip/Org. Caselli - Via Magenta, 19
- 50123 - Firenze - tel. 055.287388 - quirino@caselli.it

Aktivite të brendshme

➤ Pantagruel (Shoqata)

- *Aktivite mbështetjeje dhe pune të brendshme dhe të jashtme. (ndërtim Kukullash femërore në Sollicciano). Realizimi i një gazete femërore. Arkivimi i gazetave të burgut të Toskanës.*

PËR KONTAKTE: *Domandina diretta*

Giuliano Capecchi Via Tavanti, 20 - Firenze - tel. 055.473070
asspantagruel@virgilio.it - www.informacarcere.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

➤ Società di S. Vincenzo de Paoli

- *Asistencë dhe mbështetje për të burgosurit dhe informacione të jashtme mbi realitetin e burgut.*

PËR KONTAKTE: *Domandina diretta*

Via degli Alfani, 47 - 50121 - Firenze - tel. 055.211378

Referente: Anna Giulia Marchi - annagiulia.marchi@katamail.com

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

> Scuola Edile

- Kurse formimi profesional në sektorin e ndërtimeve. Stazhe jashtë burgut. Formim dhe futje pune në Solliccianino (Gozzini). Kontakte: Zyra e Edukatorëve.

PËR KONTAKTE:

Zoti. Bruno Ferrari Via L. il Magnifico, 8 - 50129 - Firenze - tel. 055.4625035
angelazampini@scuolaedile.fi.it - www.scuolaedile.fi.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

> Telefono Azzurro (Shoqata Onlus)

- Mbështetje mamave të burgosura dhe fëmijëve të tyre. Shoqërimi i fëmijëve në kopësht. Mbështetje e projektit Theo për pritjen jashtë të mamave, që janë në gjendje burgimi me fëmijë.

PËR KONTAKTE: Domandina diretta

Silk Stegemann Via Assisi, 20 - tel. 055.781481
sstegemann@inwind.it - firenzeazzurro@azzurro.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

> UISP (Shoqata)

- Aktivite motorie dhe aktivite lojrash - sportive për të burgosurit pranë Institutit të ruajtjes së lehtë M. Gozzini (Solliccianino). Kontakte: Zyra e Edukatorëve.

PËR KONTAKTE:

Orlando Materassi Via Bocchi, 32 - Firenze - tel. 055.6583501
solidarieta@uon.it

Aktivite të brendshme dhe/ose të jashtme

7.1 ZYRAT PUBLIKE

ZYRAT PUBLIKE TË BURGUT

➤ BURGU SOLLICCIANO

Via G. Minervini, 2r - 50142 - Firenze
tel. 055.73721

➤ BURGU MARIO GOZZINI "SOLLICCIANINO"

Via G. Minervini, 8r - 50142 - Firenze
tel. 055.755421 / 055.755451

➤ SEKSIONI SEMILIBERI

Via della Mattonaia, 6 - 50121 - Firenze
tel. 055.7372490

➤ ZYRA PËR EKZEKUTIMIN PENAL TË JASHTËM - UEPE (EX CSSA)

Borgo La Croce , 60r - 50126 - Firenze
tel. 055.263191

➤ GJYKATA E MBIKQYRJES (*TRIBUNALE DI SORVEGLIANZA*)

Via Cavour, 57 - 50121 - Firenze
c/o Gjykata e Apelit (*Corte d'Appello*)
tel. 055.50051

SHËRBIMET SOCIALE TË KOMUNËS SË FIRENCES

➤ SIAST N° 1

Via Verdi, 24 - 50125 - Firenze - tel. 055.2769629
Oltrarno - tel. 055.218930
S. Jacopino - tel. 055.334301

➤ SIAST N° 2

Via Gabriele D'Annunzio, 29 - 50135 - Firenze - 50135
tel. 055.6264907

> SIAST N° 3

Piazza Elia della Costa,3 - 50126 - Firenze
tel. 055.6817411

> SIAST N° 4

Villa Vogel - Via delle Torri, 23 - 50142 - Firenze - 50142
Isolotto - tel. 055.7875001
Lungarno S. Rosa - tel. 055.2287811

> SIAST N° 5

Via Lambruschini, 33 - 50134 - Firenze
tel. 055.2767071

> ZYRA E BURGUT

Via Verdi, 24 - 50125 - Firenze
tel. 055.2769785

> GARANTE DETENUTI

Piazza della Parte Guelfa, 23 - 50123 - Firenze
tel. 055.2769138 - 055.2769137

> ALBERGO POPOLARE

Via della Chiesa 66 - Firenze
tel. 055.211632

SHËRBIMET PËR TOKSIKOMANËT DHE ALKOLISTËT ASL 10 - FIRENCE

> FIRENZE - SERT A

Borgo Pinti, 68r - 50121 - Firenze - tel. 055.246061
Via dell'Arcolaio, 2/a - 50135 - Firenze - tel. 055.6264054

> FIRENZE - SERT B

Piazza del Carmine, 17 - 50124 - Firenze - tel. 055.287299
Lungarno S. Rosa, 13 - 50142 - Firenze - tel. 055.2285667

> FIRENZE - SERT C

Via L. Il Magnifico, 102 - 50129 - Firenze - tel. 055.6264430
Villa Basilewsky - Via L. Il Magnifico, 104 - 50129 - Firenze -
tel. 055.6264436

> SERT SESTO FIORENTINO

Via Gramsci, 161 - 50019 - Sesto Fiorentino (FI)
tel. 055.4498323

> SERT CAMPI BISENZIO

Via dei Bruni, 49 - tel. 055.8960218

> SERT SCANDICCI

Via Rialdoli, 80 - 50018 - Scandicci (FI)
tel. 055.7294240

> SERT CHIANTI - BAGNO A RIPOLI

c/o Ospedale Ponte a Niccheri - Via dell'Antella, 58 - 50011 - Antella
(FI) - tel. 055.2496210

> SERT FIGLINE VALDARNO

c/o Presidio Ospedaliero Serristori
tel. 055.9508330

> SERT MUGELLO - BORGO S. LORENZO

Via F. Niccolai, 23 - 50032 - Borgo San Lorenzo (FI)
tel. 055.8495143

